

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7684 E premte 19 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**P**ërse po bie interesi i të rinjve për studimin e shkencës në shkolla dhe universitete, kur presioni i teknologjive inteligjente mbi ekonominë dhe jetën ...  
Vijon në faqet 20-21

Nga PELLUMB KARAMETA

Arsimi dhe formimi shkencor përballë sfidave



Opinion

Ditës

**B**rezi i 50-vjeçarëve që lindi në sistemin monist u mësua që të flitej në emër të popullit, pra edhe në emër të tyre. Zakonisht nuk pyeti se ku e morën ...  
Vijon në faqet 21

Nga SINAN TAJ

Të ndihesh askushi



“Orientonte shitësit në ish-Bllok”  
**Stresi në përgjim prej 1 viti, policia: Pjesë e një grupi prej 25 personash**

Policia: Kishte rol periferik, pritët të vihen në pranga “të tjerë kriminele”

TIRANË - Një ditë pas arrestimit të këngëtarit Arkimed Lushaj, i njohur ndryshe si Stresi, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen që bëri bujë në media. Kjo për faktin se nuk pritej që 31-vjeçari me gjithë karakterin rebel e që merret me art të ishte anëtar i një grupi kriminal. Mësohet se ai është i pari nga anëtarët ...  
Në faqet 7

RELACIONI I QEVERISE: BASTET SPORTIVE MUND TE JENE MONOPOL SHTETEROR

## MBYLLJA E KAZINOVE, KERCENIME NGA BURGÛ

Kuvendi, procedurë e përshpejtuar për ligjin që ndalon kumarin. Kryeministri: Deputetët e PS u kanosën me mesazhe nga qelitë. Vasili: Çoji në prokurori



(Në foto) Kryeministri Edi Rama duke folur gjatë një seance parlamentare

NDERKOMBETARET

**OSBE, letër Ramës: Paketa e qeverisë “antishpifje” cenon lirinë e medias**

Në faqet 4

MES TYRE, BIRRA “KORÇA”

**Prodhimet “Made in Albania”, në 600 lokale në mbarë botën**

Në faqet 8

16-VJEÇARI NE FIER

**Vrau shokun e ngushtë me thikë, dorëzohet në polici. Flasin dëshmitarët**

Në faqet 6

ÇESHTJA KOMBETARE

**“Kalvari diplomatik i Kosovës”, diplomati Shaban Murati promovon librin e ri**

Në faqet 18

KRYETARI I PD



**“Alarmi” i Bashës: Vendi në rrezik, mund të shkohet në përplasje civile**

Në faqet 5

DOSSIER/ Zbulohet letra e nëntorit të vitit 1974, që iu dorëzua edhe Hysni Kapos

## Ankesat e Tefta Camit për Haxhi Lleshin tek Enveri

Dokumenti “sekret”: Ai kërkon të krijojë opinione kundër meje

NGA DASHNOR KALOÇI

**D**iku nga viti 1973-’74, me rastin e festave jubilarë të 30-vjetorit të formimit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe “çlirimit të vendit nga pushtuesit nazi-fashistë”, festa, të cilat do të përkujtoheshin me mjaft pompozitet dhe parade



ushtarake madhështore, me porosi nga Komiteti Qendror i PPSH-së, në disa rrethe të Shqipërisë u bënë propozime që disa dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare t’iu akordohet titulli i lartë “Hero i Popullit”. Gjë e cila ndodhte zakonisht ...  
Në faqet 16-17

## "KUMARI" VENDIMI

Zbardhet relacioni i vendimit që bllokoi lotot që nga 1 janari 2019

# Ideja e qeverisë: Bastet sportive, po mendojmë idenë e monopolit shtetëror

"Mund të ushtrohet nga struktura të posaçme"

Pikat e basteve mund të jenë monopol sh t t e r o r . "Enigma" është zgjidhur nga vetë qeveria nëpërmjet relacionit të projektligjit të depozituar në parlament.

Në draftin "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë" brenda 31 dhjetorit mbyllet të gjitha aktivitetet e basteve sportive që ushtrohen nga kompanitë private, duke ofruar si "zgjidhje" krijimin e një monopoli shtetëror. "Qëllimi i këtij projektligji është ndërprerja e ushtrimit të aktivitetit të basteve sportive dhe të basteve për garat në pistë, me përmbushjen e afatit të përcaktuar në këtë projektligj, deri në datën 31 dhjetor 2018. Ky projektligj është në të njëjtën linjë me ndalimin ligjor të parashikuar për kazinotë elektronike dhe bingo tradicionale, të cilat kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri më 31 dhjetor 2018. Ky projektligj synon të ndjekë të njëjtën logjikë dhe të njëjtin afat edhe për kategoritë "Baste sportive" dhe "Baste për garat në pistë". Për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie po konsiderohet mundësia e trajtimit të saj si monopol shtetëror dhe ushtrimi i kësaj veprimtarie nga struktura shtetërore të ngritura posaçërisht.

**RELACION PËR PROJEKTILIGJIN "PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LOJËRAT E FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Qëllimi i këtij projektligji është ndërprerja e ushtrimit të aktivitetit të Baste sportive" dhe "Basteve për garat në pistë", me përmbushjen e afatit të përcaktuar në këtë projektligj, deri në datën 31 dhjetor 2018. Ky projektligj synon të ndjekë të njëjtën logjikë dhe të njëjtin afat edhe për kategoritë baste sportive dhe baste për



Foto ilustruese

garat në pistë. Për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie po konsiderohet mundësia e trajtimit të saj si monopol shtetëror dhe ushtrimi i kësaj veprimtarie nga struktura shtetërore të ngritura posaçërisht.

**II. VLERËSIM I PROJEKTAKTIT NE RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA**

Projektligji është në përputhje me zbatimin e objektivave të parashikuar në programin e qeverisë, për veprimtarinë në fushën e lojërave të fatit.

Projektligji nuk është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten gjatë vitit 2018 për shqyrtim, pranë Këshillit të Ministrave, miratuar me vendim nr.37, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave.

**II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**  
Miratimi i këtij projektligji synon ndërprerjen e ushtrimit të aktivitetit të

lojërave të fatit për kategoritë "Baste sportive dhe "Baste për garat në pistë", me përmbushjen e afatit të përcaktuar në këtë projektligj deri në datën 31 dhjetor. Ky projektligj është në të njëjtën linjë me ndalimin ligjor të parashikuar për kazinotë elektronike dhe bingo tradicionale, të cilat kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri më 31 dhjetor 2018. Ky projektligj synon të ndjekë të njëjtën logjikë dhe të njëjtin afat

Qëllimi i këtij projektligji është ndërprerja e ushtrimit të aktivitetit të Baste sportive" dhe "Basteve për garat në pistë", me përmbushjen e afatit të përcaktuar në këtë projektligj, deri në datën 31 dhjetor 2018. Ky projektligj synon të ndjekë të njëjtën logjikë dhe të njëjtin afat edhe për kategoritë baste sportive.

**MINISTRIA E FINANCAVE**  
Drejtori i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave, Niko Lera, për mediat vizive do të shprehet se grupi i punës po analizon disa alternativa, duke marrë si shembull praktikat evropiane, duke mos përfshirë mundësinë e krijimit të monopolit shtetëror.

edhe për kategoritë "Baste sportive" dhe "Baste për garat në pistë". Për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie po konsiderohet mundësia trajtimit të saj si monopol shtetëror dhe ushtrimi i kësaj veprimtarie nga struktura shtetërore të ngritura posaçërisht për ushtrimin e tij.

**IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHËRISË DHE HARMONIZIMI ME**



Gjatë një seance parlamentare

**LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME 'ACQUIS COMMUNAUTARE'**

Ky projektligj nuk ka për qëllim përaftrimin e ndonjë 'acquis' të BE-së.

**VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGJËSE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar në 2 nene:

Në nenin 1, të këtij projektligji,

në pikën 1, të nenit 1 të këtij projektligji bëhet shpresa me këtë përmbajtje: Bëhet një shtesë dhe ndryshim "2/1. Organizatorët e kategorive "Baste sportive" dhe "Baste për garat në pistë" do të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018. Të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë për kategoritë e sipërpërmendura në proces shqyrtimi ndërpritin. Ky propozim bëhet

me qëllim ndërprerjen e ushtrimit të aktivitetit të lojërave të fatit për kategoritë "Baste sportive" dhe "Baste për garat në pistë", me përmbushjen e afatit të përcaktuar në këtë projektligj, deri në datën 31 dhjetor 2018, si dhe mosvijimin e procedurës së licencimit për subjektet që kanë depozituar kërkesën e tyre për pajisjen me licencë, për këto kategori, pranë strukturës përgjegjëse.

Në pikën 2, të nenit 1, të këtij projektligji bëhen këto ndryshime:

Fjalët "Basteve sportive" dhe "Baste për garat në pistë" hiqen si dhe fjala "të kategorive" zëvendësohet me fjalën "e kategorisë".

Ky propozim bëhet me qëllim që aktiviteti i lojërave të fatit për kategoritë "Bingo televizive", të mbetet i paprekur nga trajtimi që i bëhet me këtë ligj kategorive "Baste sportive" dhe "Baste për garat në pistë".

**VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomia dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

**VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomia

**IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.





Kuvendi procedurë e përshpejtuar për bastet, të enjten e ardhshme votohet ligji

# Mbyllja e kazinove: Deputetët e PS janë kërcënuar nga burgu 313

*Kryeministri, propozime për bizneset dhe të papunët*

**P**rojektligji për lojërat e fatit hyn me procedurë të përshpejtuar seancën e ardhshme. Kuvendi votoi me 71 vota kërkesën e socialistëve për futjen e projektligjit për "Lojërat e fatit" me procedurë të përshpejtuar. Kërkesa e maxhorancës u bë dje gjatë seancës së Kuvendit, seancë në të cilën opozita mungoi sërish. Projektligji parashikon mbylljen e pikave të basteve dhe zhvendosjen e kazinove jashtë qendrave të banuara. Gjatë seancës së djeshme plenare, Kryeministri Rama i kërkoi Taulant Ballës dhe kreut të parlamentit Gramoz Ruçi që ligji për mbylljen e kazinove dhe basteve online të shkojë në Kuvend me procedurë të përshpejtuar.



Kryeministri Edi Rama

**KËRCËNIMI**

Z.Rama akuzoi se deputetët të Komisionit të Financave janë shënjestruar nga një sulm vulgar i mesazheve të orkestruara nga burgu 313. "Jam i keqardhur që një pjesë e deputetëve, dhe posaçërisht deputetët e Komisionit të Financave dhe Ekonomisë janë kthyer në një shenjestër e një sulmi vulgar mesazhesh të orkestruara nga burgu 313", tha Rama.

**SPAK DHE BYROJA**

Në vitin 2019 do të nisnin hetimet për korrupsion në nivelet më të larta të shtetit. Ky është afati i parashikuar për nisjen e funksionimit të Byrosë së Hetimit dhe SPAK. Në buxhetin e vitit 2019 është parashikuar një fond prej 500 milionë lekësh, ku përfshihen edhe KLGJ e KLP. Po ashtu, në total për të gjitha institucionet e drejtësisë fondi shkon në 2.55 miliardë lekë.

**PUNËSIMI**

Kryeministri ofron dhe një zgjidhje për pronarë pikash basteve si dhe do të jetë prioritet punësimi i tyre. "Kjo është një mundësi për ata që kanë pika basteve, që kanë investuar në këto pika, që të mos rrinë të ankohen, që të mos i bashkohen llumit, që të mos marrin pjesë nëpër fushata shpifjesh online por që të mendojnë transformimin e pikës së tyre në një biznes të shëndetshëm dhe fitimprurës me taksën 5%. Ashtu si kundër nga ana tjetër do të jetë prioritet të gjitha ata që do të dalin pa punë, nga këta që janë punonjës dhe që duan të punojnë. Se kjo hap vende pune o plako, o plako nuk ka vende pune është një moto online e atyre që rrinë në kafe dhe që e presin punën t'i zgjojë në mëngjes dhe mundësisht pas orës 9. Nuk jetohej me 240 mijë lek plako. E di vëllai. Por 240 mijë lekëshi është paga më e ulët për ata që nuk kanë asgjë tjetër përveç krahut të punës dhe dëshirës për punë ndërkohë që shumë të tjerë e fillojnë me 240 mijë, shkojnë 300, 400, 600 dhe nuk është absolutisht e rastit se edhe një ulje tjetër që bëhet në paketën fiskale për ata që kanë rrogën nga 1.2 deri në 1.5 milionë lehtëson 16 mijë nërëz. Janë 16 mijë vetë në Shqipëri të punësuar që kanë këtë rrogë dhe shumica në sektorin privat. Nuk ka gabuar Bledi Klosi, por thjesht sportiviteti i tij e ktheu në një fakt kur tha: Ka punë por s'ka specialistë", deklaroi z.Rama.

**Kërcënimet, Vasili: Pse nuk i dërgon në prokurori si 'shpifjet'?**

**D**uke marrë shkasë nga deklaratat e kryeministrit Rama për kërcënime të deputetëve nga burgu 313 pas vendimit për mbylljen e basteve, kreu i Grupit të LSI-së, Petrit Vasili pyet pse nuk i dërgojnë në prokurori kërcënime të tilla. "Këta të Rilindjes janë të gatshëm të denoncojnë çdo shpifje të pretenduar nga ata si e tillë, por jo kërcënimet e pretenduara nga mbështetësit e basteve. Pse nuk i dërgojnë në prokurori? Ç'frikë i ndal? Nëse nuk i çojnë është e qartë, që gënjejnë. Si gjithmonë...", shprehet z.Vasili. Kryeministri Rama dje denoncoi në Kuvend se deputetët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave po sulmohen me mesazhe të orkestruara nga dhomat e burgut tek 313. "Jam shumë i keqardhur që një pjesë e deputetëve, dhe posaçërisht deputetët e Komisionit të Financave dhe të Ekonomisë, janë kthyer në një shenjestër të një sulmi vulgar, të orkestruar nga burgu 313", tha z.Rama.



uptimin që për sa i përket online-it, që është një drejtim shumë kompleks siç tregojnë në vendet tjera do të arrijnë në një konkluzion të studiuar mbi bazën të cilët do të mund të kemi një diskutim më tutje, të mëvonshme. Ka propozime të ndryshme edhe për sa i përket idesë së monopolit shtetëror të lojërave të fatit, basteve sportive që sot po iu them jam kundër megjithatë janë të gjitha të hapura për diskutim. Ama në 1 janar të vitit të ardhshëm ne do ta sanksionojmë këtu në parlament dhe nuk

ka më asnjë lloj basti, asnjë lloj kazinoje elektronike në asnjë zonë të banuar. Ka edhe një temë tjetër që është i rëndësishëm të theksohet sepse janë bërë spekulime dhe me çështjen e kazinove elektronike dhe spostimin me demok në periferi. Nuk ka asnjë spostim në periferi por kazinotë do të jenë të mundura vetëm për hotelet apo resortet me 5 vje në zonat e definuara me vendim të qeverisë dhe të gjitha autoriteteve përkatesë të planifikimit të territorit si zona turistike", theksoi z.Rama.



**Balla, thirrje opozitës: Ejani në parlament, të votojmë 'bastet'**

**K**reu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i bëri dje thirrje opozitës të kthehet në Kuvend për të votuar projektligjin për bastet. Balla kërkoi të miratohet vendimi për kalimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit për bastet dhe javën e ardhshme të vijë në seancë për t'u votuar. "Unë kam besim që Kuvendi sot, grupi i PS do ta mbështesë vendimin për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar, i bëj thirrje PD-së që në largimin me bojkat pa arsye të shfrytëzojë seancën e së enjtes për t'u kthyer në parlament dhe për të votuar këtë projektligj të rëndësishëm. Nuk ka vëmendje më të madhe për njerëzit se sa PD dhe LSI dhe Dash Shehi dhe Vangjel Dule të vijnë të enjten e ardhshme në seancë dhe të votojnë këtë projektligj shumë të rëndësishëm", deklaroi z.Balla.

**MONOPOLI**

Para deputetëve të mazhorancës, Kryeministri Rama pranoi se çështja ishte komplekse ndërsa u shpreh kundër monopolit shtetëror të lojërave të fatit. Ky ishte propozim i kryetarit të komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe pak ditë më parë. "Me mirë-



**Rama nxjerr Berishën në kazino**

**K**ryeministri Rama e kvazhdoi nga rrjetet sociale 'luftën' e tij për mbylljen e lojërave të fatit. Në 'Instagram' postoi një foto të ish-kryeministrit Berisha pranë një makinë loje fati. Rama krahas fotos shkruan se bastet nuk i shpëton as dëshpërimi i lojtarëve të fatit, as para ja e kërimit të organizuar që financon industrinë e baltës kundër mbylljes së tyre dhe as hungërimat e derrave apo pickimet e mushkonjave të kënetës mediatiqe" - shkruan Rama. Fotoja e Berishës është shkrepur gjatë kohës që ka qenë President i Republikës i fotografuar nga agjencia e huaj e fotove CORBIS në një ceremoni të hapjes së lojërave të para të fatit në Shqipëri.

# NISMA E QEVERISË REAGIMET

Rama, bisedë me Desir: Paketa antishpifje, të hapur për çdo sugjerim

## Mbyllja e portaleve, OSBE letër Ramës: Cenon lirinë e medias

Mbyllet afati, AKEP: Portalet janë regjistruar

Valentina Madani

OSBE e sheh si cenim të lirisë së medias mbylljen e portaleve 'online'. Përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e medias, Harlem Desir, shprehu dje shqetësimin për lajmërimin për një sistem të ri regjistrimi për 44 faqe interneti në Shqipëri dhe mbylljen e mundshme të tyre. Më 15 tetor, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Shqipëri publikoi një listë me 44 faqe interneti mediatike, që duhet të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të pajisen me NIPT brenda 72 orësh, të cilin duhet ta publikojnë pastaj 'online'. Mosrespektimi i këtij urdhri rezultoi në mbyllje të faqeve të internetit. Kjo nisim, sipas qeverisë bëhet për t'u dhënë zgjidhje shpifjeve 'online'. Por, OSBE jep alarmin se mund të sjellë efekte shumë negative në lirinë e medias. "Shtetet nuk duhet të imponojnë regjistrimin e detyrueshëm për mediat 'online' si parakusht për punën e tyre, gjë që mund të ketë efekt shumë negativ në lirinë e medias. Kjo praktikë, kur vihet në zbatim, mund të kufizojë ndjeshëm aksesin e publikut në burime të larmishme informacioni dhe pluralizmin e zërave, si edhe gërryen të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit 'online'", deklaroi Desir. Ai u bëri thirrje autoriteteve shqiptare t'i rishikojnë këto masa, të shyrtojnë të gjitha alternativat e mundshme për trajtimin e çështjes së shpifjes dhe të fillojnë një debat gjithëpërfshirës me aktorët relevantë të shoqërisë civile dhe medias. "Është tejet e rëndësishme që të sigurohet më shumë informacion rreth objektivave të saktë të masave të shpallura, si edhe për kriteret mbi bazën e të cilave janë përgjdhur këto 44 faqe interneti", tha z.Desir.

**REAGIMI**

Kryeministri Edi Rama reagoi dje pas qëndrimit të OSBE-së dhe ka deklaruar se është i hapur për të diskutuar dhe për të pranuar çdo sugjerim për të miratur paketën antishpifje dhe



Përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e medias, Harlem Desir

**PAKETA**

Paketa antishpifje e iniciuar nga kryeministri Rama nis me legalizimin e portaleve. Kryeministri i cilësoi si "fantazma" pa adresë dhe pa emër, portalet e paregjistruara në Qendrën Kombëtare të Bizneseve. Të hënën AKEP publikoi një listë me portalet e paregjistruara dhe la afat 72 orë që të publikojnë numrin e NIPT-it në faqen e tyre 'online', pasi në të kundërt do të bëhet mbyllja e çdo portali të paregjistruar.

**Vokshi: Antikushtetues dhe i paligjshëm**

### Ultimatumi për portalet, PD i kërkon AKEP të pezullojë urdhrin

Deputetja e PD-së, Albana Vokshi i dërgoi dje një letër publike kreut të AKEP, Ilir Zela, të cilit i kërkon që të pezullojë urdhrin për regjistrimin e portaleve në Qendrën Kombëtare të Bizneseve dhe publikimin e NIPT-it. Sipas kryetares së Komisionit të Medias, urdhri është antikushtetues dhe i paligjshëm, në shkelje të hapur të kompetencave që i njeh ligji për komunikimet elektronike. Vokshi renditi shkeljet që bën urdhrin i datës 15 tetor i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për regjistrimin e portaleve 'online' në



Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe publikimin e NIPT-it në faqet e tyre. "Në shkelje të hapur të kompetencave që i njeh ligji për komunikimet elektronike, në është shkelje flagrante të lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave, të

anti-'fake news'. Në një postim në "Twitter", Rama bën të ditur se ka pasur një bisedë të frytshme me Harlem Desir, përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias. "Bisedë e frytshme me Harlem Desir mbi përpjekjet për rend ligjor në median 'online'. Së shpejti, paketa antishpifje, anti-'fake news', në diskutim publik. Gati për të dëgjuar sugjerimet e kujtdo që do një

media të çliuar nga shpifjet. @OSCE\_RFoM, partner i çmuar në këtë betejë emancipuese", deklaroi z.Rama. **AFATI**  
Pas skadimit të afatit prej 72 orësh që AKEP u la 44 portaleve për t'u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare njofton se reagimi ka qenë pozitiv, pasi janë regjistruar, me përjashtim

garantuara nga neni 22 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Si kryetare e Komisionit Parlamentar për Median, ajo i ka kërkuar zyrtarisht kryetarit të AKEP-it pezullimin e menjëhershëm të këtij urdhri antikushtetues dhe antiligjor", thuhet në letrën dërguar z.Zela. Vokshi bën të qartë se: "PD mbetet e vendosur në mbrojtje të lirisë dhe të drejtave themelore, siç është liria e shprehjes dhe e medias përballë censurës shtetërore që do të installojë Edi Rama".

të ndonjë domaini të paidentifikueshëm. AKEP thekson se po përgatit fillimin e procedurës administrative të pezullimit, bllokimit apo mbylljes për domainet.al apo nëndomainet e tij, të cilët nuk janë verifikues. Në fund të njoftimit, AKEP shprehet se mbetet i hapur për të bashkëpunuar me të gjithë institucionet që ky proces të konkludohet me efikasitet



Dje në "Opinion"

### Meta me zyrtarin çek: Një linjë ajrore direkt Pragë-Tiranë

Presidenti i vendit, Ilir Meta takoi dje kryetarin e Komisionit të Bujqësisë në Parlamentin e Çekisë, Jaroslav Faltýnek. Z.Meta vlerësoi marrëdhëniet mes dy vende, duke theksuar një intensifikim të ndjeshëm vitet e fundit. "Bashkëpunimi mes dy vendeve është intensifikuar ndjeshëm në vitet e fundit në të gjitha fushat. U jemi shumë mirënjohës të rinjve çekë për promovimin e bukurive tona natyrore. Mirënjohje për promovimin ndërkombëtar të bukurive të rralla e të panjohura të turizmit tonë malor", tha Presidenti Meta. Ai gjithashtu shprehu idenë e një linje ajrore direkt mes Pragës e Tiranës. "Ka ardhur koha që të kemi një linjë ajrore direkt mes Pragës dhe Tiranës. Linja ajrore Pragë-Tiranë të jetë funksionale gjatë gjithë vitit. Do t'i fuqizonte akoma më tepër marrëdhëniet mes dy vendeve", theksoi kreu i shtetit.

### Vakancat në KQZ, Ruçi-partive: Sillni emrat zëvendësues

Kuvendi është njoftuar zyrtarisht për katër vakancat e krijuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në nisje të seancës së djeshme plenare, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi bëri me dije se KQZ-ja ka njoftuar vendet vakante si pasojë e përfundimit të mandatit të Hysen Osmanajt, Vera Shtjefnit, anëtarë të propozuar në KQZ nga Partia Demokratike, Bledar Skënderaj, i propozuar nga PS si edhe Gëzim Veleshnja, i propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim. Ruçi u kërkoi krerëve të grupeve parlamentare që të çojnë në Kuvend propozimet e tyre për vendet vakante. Kjo çështje pritet të hapë debat, ndërsa më me interes pritet reagimi i PD. Kreu i KQZ-së, Klement Zguri, ia ka dërguar një letër z.Gramoz Ruçi përmes së cilës shprehet: "Duke qenë se në detyrë tashmë janë vetëm 3 anëtarë, KQZ-ja është pa kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjeve dhe veprimtarinë normale të tij".

sa më të plotë dhe t'i shërbejë sa më gjerë interesit publik. Të hënën Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare publikoi një listë me portalet e paregjistruara dhe la afat 72 orë që të publikojnë numrin e NIPT-it në faqen e tyre 'online', pasi në të kundërt do të bëhet mbyllja e çdo portali të paregjistruar. AKEP u kërkoi të gjitha mediave 'online' të regjistrohen tek Qen-

dra Kombëtare e Biznesit si çdo aktivitet tjetër që ka të ardhura dhe ka për detyrë të paguajë sigurime shoqërore të gazetarëve. Vendimi erdhi pas prezantimit nga Rama të paketës antishpifje, e cila nis me legalizimin e portaleve. Kryeministri i cilësoi si "fantazma" pa adresë dhe pa emër, portalet e paregjistruara në Qendrën Kombëtare të Bizneseve.



**K**reu i opozitës, Lulzim Basha deklaroi mbrëmë përballë një paneli gazetarësh në "Opinion" që deklarata e Edi Ramës se i ka kërkuar në tavolinë pushtetin është një shpifje. Ai u vendos përballë pretendimit të Ramës se i ka kërkuar pushtetin në tavolinë. Basha tha se PD po përgatitet për t'u futur në zgjedhje lokale dhe të përgjithshme, ndërsa shtoi se ata duan të vijnë si një alternativë dhe të fitojnë besimin e shqiptarëve përmes zgjedhjeve të lira e të pastra. Por, Basha paralajmëroi se vendi është në rrezik për një konfrontim civil. Kreu i PD-së u pyet për mundësinë e një shantazhi nga Edi Rama, për dosjen e lobimit, që PD ka bërë në SHBA gjatë zgjedhjeve të shkuara.

**Z.Basha i keni kërkuar Ramës, si me gjysmë zë, po sikur të ndajmë pushtetin herë, unë herë ti. Si mund t'ia kërkojmë?**

Duhet ta bëj të qartë që është mashtrim, idiotësi logjike. Është një mashtrim i njeriu që nuk ka as vullnet dhe as qëllimin të mirëqeverisë, as të bëjë sikur po qeveris. Është vënë në një fushatë të ethshme kundër opozitës. Ka një qëllim kjo fushatë... zbulon derexhenë që është katandisur kjo qeverisje, do të godasë besueshmërinë e opozitës, duke goditur opozitën në çdo rast, duke thënë se i kam kërkuar pushtetin.

**Pse të mos e besoj?**  
Besë çfarë të duash, pushteti në tavolinë nuk kërkohet, as merret... Është një mashtrim i keq i njeriu, i cili është në vështirësi, që nuk ka vullnet dhe as qëllim të qeverisë dhe as nuk bën sikur qeveris. Është angazhuar në një fushatë të ethshme kundër besueshmërisë së opozitës, bashkë me mediat pranë tij, analistë të paguar dhe pseudodemokratët.

**Kanë emra pseudodemokratët?**  
Ç'rëndësi ka, se po flasim politikisht... Nuk ka asnjë marrëveshje mes meje dhe atij.

**A do të hyni në zgjedhje?**  
PD po përgatitet për zgjedhje lokale dhe të përgjithshme. Qëllimi ynë është t'i imponojmë një zgjedhje politike vendit. Qëllimi ynë është që të marrim besimin e shqiptarëve për të qeverisur vendin. Kemi paraqitur një platformë, por Rama nuk e do, sepse e di që me vetingun e politikanëve, ai humbet të drejtën për të qenë në politikë dhe jo vetëm qeverin.

**Kur ju thoni se në 17 maj bëtë marrëveshje me Edi Ramën sepse ishit të detyruar për të shmangur konfrontimin civil, po sot a mendoni se ka rrezik për një**

Pushtet me marrëveshje? Kreu i PD-së: Në krah të Ramës, pseudodemokratë

# Dosje amerikane? Basha: S'ka njeri që mund të më shantazhojë mua

"Vendi rrezikon të shkojë në konfrontim civil"

**AKUZA**

Taulant Balla deklaroi se njerëz në PD dhe madje deputetë kanë vëllëzërit e tyre të dënuar për drogë jashtë vendit. Basha u përgjigj: "Unë nuk ka dijeni për deputetë të PD-së, por nëse ka emra, le t'i bëjë publike, edhe faktet. As më bëhet vonë çfarë ka thënë Balla, që nuk paska kulturë për të përmendur emrat e deputetëve që akuzohen".



Kreu i opozitës, Lulzim Basha dje në "Opinion"

**SHANTAZHI**

"Nuk mund të shantazhojë Rama as PD-në dhe as Lulzim Bashën. Lulzim Basha nuk është ulur kurrë me kriminelë dhe s'ka bërë kurrë pazare me oligarkë. Edi Rama s'ka shanse të shantazhojë Lulzim Bashën dhe PD-në. Ai bën propagandë dhe merret me makinacione e shpifje kundër opozitës", tha kreu i PD-së.

**konfrontim civil?**

Padyshim, madje po shkon më keq se një vit më parë...

**A mos ju shantazhon Edi Rama me një dosje amerikane?**

Nuk mund të shantazhojë Rama as PD dhe as Lulzim Bashën. Lulzim Basha nuk është ulur kurrë me kriminelë dhe s'ka bërë kurrë pazare me oligarkë. Edi Rama s'ka shanse të shantazhojë Lulzim Bashën dhe PD-në. Ai bën propagandë dhe merret me makinacione dhe shpifje kundër opozitës.

tazhojë Lulzim Bashën dhe PD-në. Ai bën propagandë dhe merret me makinacione dhe shpifje kundër opozitës.

**Ke një dosje në Prokurorinë e Tiranës, që ka të bëjë me lobimet?**

Ti nga e di e këtë gjë? Ti s'di asgjë.

Kemi dijeni për këtë çështje, që kanë ardhur të dhëna inkandeshente nga SHBA?

Unë po pres drejtësinë me qetësi. Dhe s'ka njeri që

tazhojë më shantazhojë mua dhe PD-në. Nuk ka shanse. Është çështje që kemi trajtuar dhjetëra herë. S'kemi asgjë për të fshehur.

**Pse thoni se do t'i jepet monopoli i lojërave të fatit 'online' një kompanie që ka lidhje me Olsi Ramën dhe Vangjush Dakon?**

A deklaroi 4 vite më parë fundin e marrëzisë? Sa ishin atëherë me statistika? Ishin 840. Sa janë tani? 4200. Kush

janë aksionerët kryesorë? Njerëzit e lidhur me pushtetin. E keni parë ligjin? Po jepet monopoli një kompanie 'online', që qartësisht është në duart e Edi Ramës, të Olsi Ramës dhe Vangjush Dakos. Vërtetimin për këtë ne e kemi treguar si opozitë. Personat e lidhur me këtë koncesion dhe kontratë, zinxhri i personave të çon te personat e lidhur me kryeministrin. E njëjta gjë që ndodhi 5 jetë përpara me atë personin që u vra te Tirana e Re po ndodh sot. Një ndër aksionerët kryesorë të 'Apex', njeri shumë i afërt i Edi Ramës u ka shitur 4 muaj më parë aksionet e 'Apex'-it austriakëve. Pse them i afërt i Edi Ramës? Cuditërisht ky njeri po merr lejen e ndërtimit te Sahati dhe po ia marr ish-mikut të Edi Ramës, Ilir Matës. Ka marrë edhe dy kula në qendër të Bllokut.

**Pse nuk propozoni t'i mbyllnit ju si parti konservatore?**

Unë kam qenë i pari që kam propozuar për zhvendosjen e tyre tek Kombinati i Autotaktorëve. Pra, largimin e tyre nga të gjitha pikat e qytetit dhe ky propozim u rrëzua për shkak të mungesës së mazhorancës në këshillin bashkiak. Absolutisht që PD zotohet që do t'i mbyllë të gjitha, por nuk do të lërë monopolin e vëllait të kryeministrin ndaj basteve. As të atij që është sot dhe as atij që do vijë nesër. Ky është ndryshimi mes meje dhe Ramës, mes PD dhe PS. Edhe atëherë kur propozon një masë gjoja në interes publik, fshihet një lepur i madh mbrapa. Lepuri i madh është Vangjush Dako dhe Olsi Rama.

**Pse nuk propozoni t'i mbyllnit ju si parti konservatore?**

Unë kam qenë i pari që kam propozuar për zhvendosjen e tyre tek Kombinati i Autotaktorëve. Pra, largimin e tyre nga të gjitha pikat e qytetit dhe ky propozim u rrëzua për shkak të mungesës së mazhorancës në këshillin bashkiak. Absolutisht që PD zotohet që do t'i mbyllë të gjitha, por nuk do të lërë monopolin e vëllait të kryeministrin ndaj basteve. As të atij që është sot dhe as atij që do vijë nesër. Ky është ndryshimi mes meje dhe Ramës, mes PD dhe PS. Edhe atëherë kur propozon një masë gjoja në interes publik, fshihet një lepur i madh mbrapa. Lepuri i madh është Vangjush Dako dhe Olsi Rama.

## Reagimi, Cika: Shantazh i pastër politik

# Qeveria nxjerr nga zyra Shoqatën Antikomuniste të të Përndjekurve

**M**inistria e Drejtësisë i ka kërkuar në datën 16 tetor Shoqatës Antikomuniste të drejtuar nga z.Nebil Cika që të largohet nga zyrat në godinën e kryesisë së Kuvendit. Ministria e Drejtësisë e justifikon këtë me arsyetimin se, "vë në rrezik sigurinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Komisionari Publik të Vetëingut". Shoqata Antikomuniste e ish-të përndjekurve politikë e konsideron urdhrin e Ministrisë së Drejtësisë si dëbim-internalizim që u bëheshin njerëzve gjatë diktaturës, ku të ashtuquajturit armiq të komunizmit nxirreshin nga banesat dhe pronat e tyre, burgoseshin, dëboheshin e internoheshin në fshatrat e humbura e të izoluar. "Ne i kërkojmë qeverisë shqiptare të heqë dorë nga këto praktika komuniste shantazhi ndaj të përndjekurve politikë antikomunistë, që kanë



si qëllim pengimin e punës sonë, mbylljen e gojës për krimet komuniste dhe padrejtësitë e tjera që i janë bërë e po i bëhen shtresës sonë nga komunistët dhe pinjollët e tyre politikë e gjenetikë dhe të garrantojë kushtet bazike të funksionimit të shoqatës, siç janë zërat pa të cilat aktiviteti ynë është i pamundur. U kërkojmë autoriteteve të larta shtetërore, presidentit etj., të ushtrojnë autoritetin e detyrës për të ndaluar rikthimin e metodave të luftës së klasave. I bëjmë thirrje opozitës të reagojnë ndaj këtij shantazhi të pastër politik të qeverisë. U kërkojmë përfaqësive diplomatike perëndimore SHBA, BE etj., të përdorin autoritetin dhe ndikimin e tyre ndaj qeverisë shqiptare, me qëllim ndërprerjen e shantazhit politik ndaj nesh", thuhet në deklaratën e shoqatës.

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 09.11.2018 8 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II për shpëtim e pasurisë te paluajtshme. Arë me sipërfaqe totale 1500 m<sup>2</sup> me numër pasurisë 6/90, volumni 9 , faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi. Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillatare në ankand 17.640 (Shtatëmbdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**DEKLARATA**

**Krimi, Berisha: 30% - 40% e vrasjeve shpallen vetëvrasje**

**I**sh-kryeministri Sali Berisha deklaroi mbrëmë në "ABC News" se policia 30%-40% të vrasjeve i shpall vetëvrasje. "Policia 30%-40% të vrasjeve i shpall vetëvrasje. Kjo ndodh rëndom dhe e kam denoncuar. E dhanë dje menjëherë që kryetari i PD së Ulzës u vetëvra. Por ai s'mund të vetëvritet se ka një dorë të sëmurë", u shpreh Berisha. Përsa i përket situatës së rendit, Berisha tha se, "çdo shqiptar konstaton se të gjitha goditjet janë dhënë pas denoncimit të madh të opozitës, ose pas skandaleve dhe përlëshjeve me armë mes bandave". Në këndvështrimin e Berishës, kryeministri Rama e ka shndërruar Shqipërinë në vendin e bixhozit. Sipas Berishës, Rama po e monopolizon në duart e vëllait të vet dhe Partisë Socialiste. "Po krijon dhe monopolizon në duart e të vëllait të vet, Gjushit, Gazmend Hoxha, do i them Gaz Rama dhe kanë gjetur ca emra turq, qipriotë. Atij i kanë dërguar me qindra mesazhe, se po i merr si familje lojërat e fatit. Kam qenë për politikë kufizuese. Unë nuk jam i ekstremeve, por për politikë kufizuese, ndërka këta morën politika nxitëse e kthen në një epidemi. Lojërat e fatit i merr familja Rama", deklaroi z.Berisha.

**TIRANË** - Kryetari i Bashkisë së Krujës, Artur Bushi është thirrur dje në Prokurorinë e Tiranës për të dëshmuar në lidhje me çështjen e Xhisiela Malokut. Ai u paraqiti në organin e akuzës rreth orës 10:30, ndërsa qëndroi aty për disa orë. Emri i Bushit u lakua nga oficeri i policisë Emiljano Nuhu, si një nga zyrtarët që ndikoi që çështja në fjalë të mos bëhej publike, pasi pas denoncimit të Xhisiela Malokut fshihej Rexhep Rra-



**Artur Bushi: Berisha hedh baltë ndaj meje**

**Dosja "Xhisiela", kryebashkiaku i Krujës thirret për të dëshmuar në Prokurorinë e Tiranës**

ja, djali i deputetit të Partisë Socialiste, Rrahman Rraja. Mësohet se Bushi ka thënë në prokurori se ai nuk ka qenë në Komisarariat e Fushë-Krujës ditën kur Nuhu pretendon se është kërcënuar me pistoletë nga

Rrajat. Sipas tij, kjo vërtetohet nga qelizat e telefonit dhe dëshmitë e disa personave të tjerë. Pak pas daljes nga ambientet e prokurorisë së kryeqytetit, kryebashkiaku Bushi dha edhe një prononcim për mediat. Ai u shpreh

se emri i tij përfliet për shkak të baltës që ish-kryeministri Sali Berisha hedh ndaj tij. "Gjithmonë është përfolur emri im, është vazhda e baltës së hedhur nga Saliu ndaj meje. Jemi mësuar me këtë pjesë", tha Bushi, ndërsa nuk

dha detaje rreth dëshmisë së tij në prokurori. Dy ditë më parë djali i deputetit Rraja u la në burg, ndonëse kërkoi lirinë. E pranishme jashtë ambienteve të Gjykatës së Tiranës ishte edhe ish-e dashura e tij, Xhisiela Maloku, e cila bëri edhe "avokatin" mbrojtës së Rexhepit, pavarësisht se denoncimi i saj e çoi atë pas hekurave. Ajo tha se Rexhep Rraja nuk e kishte dhunuar dhe as përndjekur dhe se ky sipas saj ishte versioni i vërtetë i ngjarjes.

Ngjarja në qendër të qytetit, policia: Sherri mes 2 gjimnazistëve, për motive të dobëta

**Vrau shokun e ngushtë me thikë në zemër, vetëdorëzohet në polici autori**  
*Dëshmitarët: 16-vjeçari eci pak metra me armën e ftohtë ngulur në gjoks dhe u shemb në tokë*

FIER

Një 16-vjeçar është vrarë me thikë në zemër pas një sherri me shokun e tij të ngushtë. Ngjarja e rëndë ku humbi jetën Dionis Vrenoz i ka ndodhur pasditen e djeshme në qendër të qytetit të Fierit. Mësohet se Vrenoz i ka fshati Hoxharë e Vjetër është gjetur nga kalimtarët në zonën e "Zogut të Zi" pranë gjimnazit "Janaq Kilica". Ai është transportuar në spital në gjendje të rëndë, por nuk ka mundur t'i mbijetojë plagës së marrë dhe ka ndër-ruar jetë. Menjëherë pas sinjalizimit për sherrin, policia e Fierit ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Pas dëshmime të marra është bërë i mundur identifikimi i autorit të krimit. Bëhet fjalë për 17-vjeçarin Florian Gega nga fshati Dërmënas, i cili është vetëdorëzuar në polici 3 orë pas vrasjes së 16-vjeçarit. "Pas identifikimit dhe shpalljes në kërkim nga policia, dorëzohet në polici autori i dyshuar i plagosjes me thikë në 'Zog të Zi'. Në datën 18.10.2018 rreth orës 16:30, pas një zënke për motive të dobëta mes dy të rinjve, shtetasi R.G., 17 vjeç ka qëlluar me thikë shtetasin D.V., 16 vjeç. Si pasojë e plagëve të mara shtetasi D.V. ka ndërur jetë. Pas ngritjes së grupit hetimor, policia identifikoi autorin e dyshuar dhe e shpalli në kërkim. Specialistët për Hetimin e Krimit kanë bërë arrestimin në flagrancë për veprën penale "Vrasje me dashje", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

**VRASJA**  
Në rrethim, burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se Dionis Vrenoz, Florian Gega si dhe një adoleshent tjetër, emri i të cilit nuk bëhet me dije (nxënës në një nga gjimnazet e Fierit) kanë qenë shokë të ngushtë. Pasditen e djeshme, pas mbarimit të mesimit ata kanë qenë të tre së bashku në rrugë,




16-vjeçari Dionis Vrenoz



Vendi ku ndodhi vrasja

kur ka nisur debati mes Dionisit dhe Florianit. Mësohet se gjimnazisti tjetër nuk është përfshirë në sherr. Në grindje e sipër Florian i ka nxjerrë thikën dhe e ka goditur në zemër shokun e tij të ngushtë dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes. Ngjarja ka ndodhur në një vend të populluar, pranë gjimnazit "Janaq Kilica" dhe një tregu. "Ndonëse me thikë në gjoks, 16-vjeçari ka bërë ca hapa dhe më pas ka rënë tokë", thanë dëshmitarët okularë të ngjarjes, të cilët kanë njoftuar menjëherë spitalin dhe policinë.



**Xhafaj: Do keni lajme këto ditë, zbulohen dy operacionet në zhvillim**

**TIRANË** - Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj është takuar dy ditë më parë me drejtorin e policisë gjermane, Dittier Romann, ndërsa dje kanë zhvilluar një konferencë për mediat. Në fund të kësaj konferencë, Xhafaj paralajmëroi gazetarët se do ketë lajme këto ditë nga bashkëpunimi me gjermanët. "Gjatë ditëve në vijim ju këshilloj të rriini afër me Bidën dhe Gentin se do keni lajme interesante", tha ai duke iu referuar dy zëdhënësve të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit. Mësohet se bëhet fjalë për 2 operacione të Task Forcës. Një prej operacioneve në fushën e narkotikëve është duke u zhvilluar. Ekzekutimi i masave të arrestit po bëhet paralelisht në Gjermani dhe Shqipëri.

**SPANJË** - Gjatë një operacioni të zhvilluar në Spanjë janë arrestuar 15 persona për trafikim dhe shfrytëzim prostitucioni, ndërsa pas kontrolleve, autoritetet kanë liruar edhe 5 gra, të cilat detyroheshin të prostituonin. Ende nuk ka detaje të reja në lidhje me identitetin e të arrestuarve, por hetimet janë shtrirë në nivel kapilar në disa qytete të Spanjës. Sipas policisë, personat e rrezikshëm u

**Goditet grupi kriminal i trafikut të prostitucionit, 15 persona bien në pranga, mes tyre edhe shqiptarë**

kapën në Las Palmas de Gran Canaria, Palma de Mallorca dhe Alicante dhe 5 gratë të cilat mbaheshin nën presion ishin të detyruara të paguanin një shumë prej 35 mijë euro për interes të grupit, përcjell "elpais.com". Gratë arritën të liroheshin dhe grupi kriminal mori goditje të fuqishme. Në total

janë kryer 536 operacione për të çrrënjësuar shfrytëzimin seksual, ndërsa në pranga kanë përfunduar 1,219 persona, kryesisht nga Spanja, Shqipëria, Nigeria dhe Kina. Femrat nga Nigeria silleshin me mashtrim për një jetë më të mirë. Gjithashtu nga operacionet e kryera është bërë i mundur liri-

mi i rreth 290 viktimave, të cilat shfrytëzoheshin për qëllime seksuale nga ky grup i rrezikshëm. Ndërkaq, sipas statistikave të publikuara nga mediat spanjolle, shqiptarët janë të dytët përsa i përket numrit të të arrestuarve për shfrytëzim prostitucioni në këtë vend.

**STRATI** Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Apartament Nr. 37", me sipërfaqe 69,7 m<sup>2</sup>, i ndodhur në katën e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Dajç, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 27.880 Euro.  
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 24.10.2018.**

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**STRATI** Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-Regjistruar në Regjistrin hipotekor me Nr. 2035, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale me Nr. 2460, Apartament (3+1), Nr. 22, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, Seksioni Nr. 1, ndodhur në katën e katërt të Godinës së banimit dhe shërbimit 4-7-8 katëshe plus një kat parkim, Linzë, Komuna Dajç, Tiranë, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "Eurovini" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 52.584 Euro.  
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 26.10.2018.**

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M<sup>2</sup>, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMI SULA.

ÇMIMI 5.900.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Këngëtari kishte rol periferik në grup. Priten të vihen në pranga persona të tjerë

# Arrestimi i reperit Stresi, policia: Pjesë e një grupi kriminal me mbi 25 persona

## "Ishte në përgjim prej 1 viti, orientonte shitësit e drogës në ish-Blok e periferi të Tiranës"

TIRANË

Një ditë pas arrestimit të këngëtarit Arkimed Lushaj i njohur ndryshe si Stresi janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen që bëri bujë në media. Kjo për faktin se nuk pritej që 31-vjeçari me gjithë karakterin rebel e që merret me art të ishte anëtar i një grupi kriminal. Mësohet se ai është i pari nga anëtarët e grupit kriminal që operonte në fushën e narkotikëve dhe atë të gjobëvënies që përfundon në pranga. Burime nga policia e Tiranës dje bënë me dije se Arkimed Lushaj ishte që prej afro një viti në përgjim. Stresi është përgjuar teksta komunikonte me disa persona të inkrimnuar për trafikun e drogave. Po kështu, në përgjimet ambientale dhe ato telefonike, këngëtari është kapur duke orientuar shitësit të çojnë drogë në disa vende, kryesisht lokale në zonën e ish-Blokut, por edhe në periferi të kryeqytetit. Po kështu, burime të sigurta nga policia thanë për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se në grupin kriminal me mbi 25 persona, Stresi nuk ka rol drejtues, por periferik. Urdhri i arrestit ndaj tij u ekzekutua mbrëmjen e së mërkurës, pasi kishte informacion se do ikte jashtë shtetit. Ndërkaq, burimet e mësipërme pohuan se në ditët në vijim pritet të ketë arrestime të tjera në Tiranë, të dyshuar si pjesë e grupit kriminal, ku bënte pjesë dhe reperit Stresi. Policia po mban në vëzhgim edhe disa persona të tjerë.



Arkimed Lushaj



Momenti i arrestimit të 31-vjeçarit

### PËRGJIMI

Burime nga policia e Tiranës dje bënë me dije se Arkimed Lushaj ishte që prej afro një viti në përgjim. Stresi është përgjuar teksta komunikonte me disa persona të inkrimnuar për trafikun e drogave. Po kështu, në përgjimet ambientale dhe ato telefonike, këngëtari është kapur duke orientuar shitësit të çojnë drogë në disa vende, kryesisht lokale në zonën e ish-Blokut, por edhe në periferi të kryeqytetit.

### AKUZAT

Sipas bluve, ndalimi i Arkimed Lushajt u bë pas një hetimi disamujor në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, me metoda speciale të hetimit, që janë kryer në funksion të një grupi kriminal që operon në Tiranë në lidhje me aktivitetin e kundraligjshëm me tendencë "Trafikim narkotikësh" dhe "Krimeve kundër personit".

masën e sigurisë "arrest me burg" ndaj tij në lidhje me veprën penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarakë". Ndalimi i Arkimed Lushajt u bë pas një hetimi disamujor në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me metoda speciale të hetimit, që janë kryer në funksion të një grupi kriminal që operon në Tiranë në lidhje me aktivitetin e kundraligjshëm me tendencë "Trafikim narkotikësh" dhe "Krimeve kundër personit". Gjatë arrestimit, Stresi i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një sasi e vogël lënde narkotike e dyshuar kokainë, një armë zjarri pistoletë e tipit "Pietro Beretta", si dhe 12 fishekë të modelit 7.65 mm. Bashkë me Stresin ka qenë dhe 20-vjeçarja me inicialet P.C., e cila është nën hetim në gjendje të lirë për veprën penale "moskallëzim krimi".

## Ekzekutimi i komisar Artan Cukut, pezullohet një vit gjyqi për porositësin Bledar Jambelli

TIRANË - Pezullohet për një vit gjyqi për Bledar Jambellin, i akuzuar si porositësi i vrasjes së komisar Artan Cukut. Bledar Jambelli gjykohet në mungesë, ndërsa pezullimi i gjyqit është bërë me qëllim njoftimin e të pandehurit. Për vrasjen e Artan Cukut vuan dënimin ekzekutori Mikel Shallari. Edhe seanca e parë, e caktuar më 11 shtator ndaj dy të akuzuarve Kristian Leci dhe Bledar Jambelli u shty për shkak të mungesës së tyre. Të dy janë në kërkim nga policia. Jambelli akuzohet si urdhërues i vrasjes së Artan Cukut, ndërsa Leci si ndërmjetës. Ky i fundit është kushëri me ekzekutuesin



in real, Mikel Shallar. Në seancën e 11 shtatorit gjykata urdhëroi policinë e Beratit dhe Fierit të bëjnë kërkime dhe të njoftojnë të pandehurit. Ata nuk kanë kthyer përgjigje dhe gjykata vendosi që të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të marrë informa-

cion se çfarë po bëhet me kërkimet për këta të dy. Në momentin që kërkimet nuk japin rezultat, gjykata vazhdon të procedojë. Të dy janë në kërkim, ndërsa Mikel Shallari është dënuar me 10 vite për vrasjen, pasi mban statusin e bashkëpunëtorit të policisë.

### SHKURT

#### Vrau prindërit, prokuroria kërkon burg përjetë për Mirald Metallarin

TIRANË - Prokuroria ka kërkuar burg përjetë për Mirald Metallarin, i cili vrau prindërit e tij. Ngjarja ndodhi në Kamëz më 24 korrik të vitit që shkoi. Mirald Metallari, u konfliktua me babanë dhe shkak për këtë është bërë ndërtimi i një muri betoni, por në grindje e sipër, djali ka marrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të atit, duke e lënë të vdekur në vend. Për të ndaluar aktin e rëndë në mes hyri edhe nëna e Miraldit, Nurie Metallari, 47 vjeçe, e cila mbeti e plagosur dhe ndërroi jetë në spital për shkak të plagëve të marra. Ngjarja e rëndë tronditi opinionin publik, ndërsa dje organi i akuzës ka kërkuar burg përjetë për autorin. Pas vrasjes së të atit, Miralidi u arrestua gjatë kohës kur po transportonte nënën e plagosur drejt spitalit.

#### Vrasja e Azem Hajdarit, Izet Haxhia del para Gjykatës së Apelit më 21 nëntor

TIRANË - Ish-truproja e Sali Berishës, Izet Haxhia do të dalë në Gjykatën e Apelit më datë 21 nëntor. Mësohet se Gjykata e Tiranës i ka dhënë të drejtën e akimimit Haxhisë, ndërsa Apeli do të vendosë nëse çështja do të rigjykohej. Izet Haxhia është dënuar me 25 vite burg për vrasjen e Azem Hajdarit. Në një letër të dërguar në redaksinë e televizionit "News 24", më 12 tetor, ai bënte të ditur faktin se avokati e ka braktisur prej 2 muajsh, asnjë prokuror nuk ka shkuar ta marrë në pyetje. Ndërkohë, për herë të parë ai akuzoi vëllain, Ismet Haxhinë dhe Romeo Karajin se po sabotojnë çështjen e tij në gjykatë.

SHPALLJE ANKANDI  
Datë 24.10.2018, Ora 16:30

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë, Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të dorëzuarit Bajfar Alush Murto: "Trual" + Ndërtesa me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 81 m<sup>2</sup>, regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.

Cmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 1 000 000 (një milion e tetë mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë

SHPALLJE ANKANDI  
Datë 23.10.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë, Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Agron Shekaj Burhani dhe dorëzuarit Haxhi Halilaj Burhani: "Apartment + Trual" me sipërfaqe 62 m<sup>2</sup>, nr. pasurie 14/201, zona kadastrale 3574, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 2561 datë 07.10.1994, me adresë: Luga "15 Shtatori", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Tëpelena.

Cmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 806 400 (tetëqind e gjashtë mijë e katërqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Shoqëria përmbarimore JUSTITIA

Shpall ankandin, faza parë, për shijen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna: Apartament me nr.pas.7/21+1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sip 138.40 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKU

Cmimi me të cilin fillon shijja në ankand është 116.256 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dy qind e pesëdhjetë e gjashtë) EUR.

Ankandi zhvillohet në datën 01.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbareut gjyqësor, me adrese Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Nisma mes dy ministrive për nxitjen e diplomacisë ekonomike

# Prodhimet "Made in Albania", në 600 lokale në mbarë botën

## Birra "Korça" dhe disa prodhime tregtohen edhe në SHBA

Reth 600 restorante në diasporë me pronareshë shqiptarë apo që menaxhohen nga shqiptarët janë evidentuar nga përfaqësitë diplomatike për të qenë në dispozicion të eksportuesve dhe shoqatave të agrobiznesit në Shqipëri. Qëllimi i kësaj nisme në kuadër të diplomacisë ekonomike është shtimi dhe mundësia për rritje të potencialit të eksportit. Disa prodhime si lëngu i mollës së Peshkopisë, birra "Korça" dhe të tjera tashmë kanë prekur dhe tregjet botërore. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme organizuan eventin e promovimit të prodhimit shqiptar drejt diasporës. Ministri Peleshi tha se bujqësia shqiptare ka bërë hapa përpara, veçanërisht në eksportet. Në total 14 % më tepër janë rritur eksportet. Megjithatë eksportet mbeten ende sfida jo të lehta, të cilat kërkojnë një bashkëpunim forcash ndërministrorë. Për këtë arsye, vijoi ai, këtë databazë do ta vëmë në dispozicion të prodhuesve shqiptarë, për ta bërë më të lehtë aksesin e tyre në tregjet europiane.

### NIKO PELESHI

"Bujqësia shqiptare ka bërë hapa përpara, veçanërisht në eksportet. Në total 14 % më tepër janë rritur eksportet. Megjithatë, eksportet mbeten ende sfida jo të lehta, të cilat kërkojnë një bashkëpunim forcash ndërministrorë. Për këtë arsye - vijoi ai - këtë databazë do ta vëmë në dispozicion të prodhuesve shqiptarë, për ta bërë më të lehtë aksesin e tyre në tregjet europiane".



### DITMIR BUSHATI

Pas fazës së evidentimit të këtyre 600 restoranteve, tanimë do të bëhet kanalizimi i të gjitha energjive që këto restorante të kenë mundësi të bëjnë pjesë të asortimeve të tyre prodhime shqiptare. Element tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me promovimin apo brendimin e produkteve shqiptare është i lidhur ngushtë dhe me sistemin e incentivave që ofron qoftë qeveria shqiptare, agjenci të ndryshme apo edhe vetë BE", - tha ministri Bushati.

standarde të prodhimeve tipike, jemi duke miratuar, kemi hartuar draft ligjet për prodhimet tipike, edhe konform legjislacionit të BE-së. Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati tha se pas fazës së evidentimit të këtyre 600 restoranteve, tanimë do të bëhet kanalizimi i të gjitha energjive që këto restorante të kenë mundësi të bëjnë pjesë të asortimeve të tyre prodhime shqiptare. "Hapi i dytë i këtij projekti do të jetë kanalizimi i të gjitha energjive në mënyrë që nga këto 600 restorante dhe biznese shqiptare ne të

kemi mundësi që një pjesë të prodhimeve shqiptare që mund të eksportohen në tregjet europiane dhe të Amerikës së Veriut të mbërrijë në këtë destinacion. Element tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me promovimin apo brendimin e produkteve shqiptare është i lidhur ngushtë dhe me sistemin e incentivave që ofron qoftë qeveria shqiptare, agjenci të ndryshme apo edhe vetë BE", tha ministri Bushati. Së shpejti ky projekt do të finalizohet me një aplikacion që do të quhet "Albanian Flavors", ku do të prezantohen prodhimet shqiptare.

## Rekomandimi: Është kosto e madhe për buxhetin e shtetit

### Ministria e Financave, qeverisë: Mos lejoni më prokurim të drejtpërdrejtë

Këshilli i Ministrave rekomandon që të mos lejohet më prokurimi për vepra në partneritet publik-privat, të cilat do të krijojnë kosto të drejtpërdrejta apo të tërthorta për buxhetin e shtetit. Kërcënimet më të mëdha për pagesat që do të duhet të bëjë buxheti nga kompanitë që kanë marrë koncesione, vijnë nga firmat që ofrojnë shërbime në fushën e shëndetësisë. Në një relacion të hartuar nga Ministria e Financave dhe të dërguar pranë Kryeministrit, thuhet se projektet e programit "1 miliard" janë

të ezauruara, dhe nuk duhet të lejohen më kontratat të ndërtimit të veprave publike me PPP. Sipas llogarive të Ministrisë së Financave, pagesat që parashikohet të bëjë buxheti i shtetit në vitin 2022 për koncesionet arrijnë në 4.6% të totalit të të ardhurave, duke rrezikuar shkeljen e limitit ligjor prej 5% të të ardhurave. "Kësaj vlere mund t'i shtohen edhe pagesat për PPP-të ekzistuese dhe të reja, siç është ndryshimi i kontratës për rrugën Milot - Morinë, shërbimet në koncesionet e shëndetësisë, koncesioni i

aeroportit të Vlorës dhe ai i rrugës Kashar - Rrogozhinë, të cilat riskojnë shkeljen e rregullit fiskal", thuhet në dokumentin e Financave të siguruar nga Tv Klan. Për këtë arsye qeveria kërkon të zbatohen projekte PPP, vetëm me modelin që përdoruesi të paguajë për shërbimin dhe të mos implikohet arka e shtetit. Aktualisht buxheti i duhet të paguajë vetëm gjatë këtij viti 5 milionë dollarë më shumë se sa ishte planifikuar për koncesionin e sterilizimit dhe 400 mijë të tjera për atë të dializës.

## NJOFTIM

**Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k.** propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORÇA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjjes Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjjesa Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** në sallën e takimeve tek **"Grand Hotel Korça"**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e suportit vjetor të produktit Fire - Eye"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,800,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10:00 - 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e suportit vjetor të produktit "Fire - Eye"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **12 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**Veliaj: Rehabilitimi, domosdoshmëri për nxënësit**

**Katari dhuron 1.35 milionë dollarë për rikonstruksionin e shkollës "Jeronim de Rada"**

Së shpejti shkolla "Jeronim de Rada" në kryeqytet do të rikonstruktohet plotësisht dhe 1100 nxënësit e saj do të kenë kushte më të mira mësimi. Ambasada e Katarit i ka dhuruar Bashkisë së Tiranës 1.35 milionë dollarë për rikonstruksionin e godinës, pas një marrëveshje të nënshkruar mes kryebashkiakut Erion Veliaj dhe ambasadorit Ali bin Hamad Al-Marri. Veliaj u shpreh se ndërhyrja në këtë shkollë ishte bërë një domosdoshmëri, për shkak

të amortizimit të madh ndër vite, ndërsa theksoi se falë këtij rikonstruksioni do krijohen kushte optimale për zhvillimin e procesit mësimor.

"Ky është një projekt special për të dy: edhe për ambasadorin Al Marri, por edhe për ne si Bashki e Tiranës, për rikonstruksionin e plotë dhe shtimin e hapësirave në shkollën "Jeronim de Rada", një nga shkollat kryesore 9-vjeçare të kryeqytetit. Në

këtë projekt na janë bashkuar miqtë tanë nga Katar, për të transformuar totalisht realitetin e kësaj shkolle. Kemi vite që ndjejmë nevojën për ndërhyrje në atë shkollë: do të shtojmë një palestër të re, do të bëjmë të gjitha punimet e brendshme dhe të jashtme, do të rregullojmë të gjitha terrenet sportive, për ta kthyer në një shkollë me një turn mësimi, me sistem të ri të ngrohjes dhe ftohjes, me kushte ide-

ale për arsimimin e fëmijëve", tha Veliaj. Ndërkohë ambasadori i Katarit në vendin tonë, Ali bin Hamad Al-Marri, u shpreh se ky projekt ka për qëllim t'i sigurojë kryeqytetit një mjedis arsimor bashkëkohor, në mënyrë që Tirana të krijojë kushte të mira për edukimin e fëmijëve të saj, për zhvillimin e aftësive të tyre, si dëshmi e kujdesit që i kushton Lartësia e Tij Sheikh Temim bin Hamad Al Thani



edukimit të gjeneratës së re. Rikonstruksioni i shkollës "Jeronim de Rada" në Tiranë është një projekt që i shtohet projekteve të tjera, dhe që shënon një fazë të re bashkëpunimi të përbashkët ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë miq. Me këtë rast, dua të theksoj se ambasada e shtetit të Katarit nuk do të kursejë asnjë përpjekje për të mbështetur të gjitha nisimat që synojnë arrijtjen e këtij qëllimi", tha ambasadori i Katarit.

**Ekspertët: Mos harroni fëmijët nën 21 vjeç. Përcaktojeni qartë statusin aktual martesor**

**Lotaria amerikane, ambasada: Kujdes, përfshini bashkëshortët në aplikim**

*"Kriteret që duhet të plotësoni për t'u kualifikuar"*

Voltiza Duro

Vazhdojnë aplikimet për lotarinë amerikane deri në 6 nëntor të këtij viti, në një kohë që paqartësitë e pyetjeve e aplikantëve janë të shumta. Ditën e djeshme, në faqen e saj zyrtare, ambasada amerikane në Tiranë u është përgjigjur të gjitha kërkesave të të interesuarve për DV-2020. Sipas pyetjeve, deri më tani përfshirja ose jo e bashkëshortëve gjatë aplikimit ka krijuar jo pak konfuzion të kandidatët. Ambasada ka sqaruar se bashkëshorti/ja apo fëmijët nën 21 vjeç duhet të përfshihen në aplikim. "Ti aplikoni si aplikant/e kryesore tek aplikimi y dhe përfshin bashkëshortin (ose bashkëshorten) dhe fëmijët nën 21 vjeç të pamartuar në momentin e aplikimit. Bashkëshorti ose bashkëshortja juaj aplikon si aplikant/e kryesore tek aplikimi i tij/saj dhe përfshin bashkëshortin (ose bashkëshorten) dhe fëmijët nën 21 vjeç të pamartuar në momentin e aplikimit. Edhe fëmija mund të kryejë aplikimin e tij/saj si aplikant kryesor; nëse mbaron shkollën e mesme, që kualifikohet, përpara shtatorit 2020, parashikuar që ka numra vizash në dispozicion", theksojnë ekspertët e ambasadës.

**KRITERET**

Të gjithë aplikantët e lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së. Aplikantët duhet të kenë mbaruar arsimin e mesëm me kohë të plotë që është i barasvlefshëm me arsimimin në të paktën një shkollë të mesme amerikane (4 vjeçare, me kohë të plotë, arsimi përgjithshëm). Diplomat e shkollës së mesme gjimnaz



me kohë të plotë kualifikohen për lotarinë. Shkollat e mesme profesionale me kohë të plotë mund të kualifikohen nëse ato në thelb përputhen me kërkesat thelbësore të një të arsimi të mesëm me kohë të plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vendimi përfundimtar do të merret nga oficeri konsullor në ditën e intervistës për vizë. Diplomat e shkollës së mesme me kohë të pjesshme - pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose ato me korrespondencë, përfshirë programet pesë vjeçare ose programet e gjata (me kohë të pjesshme, pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose me korrespondencë) nuk kualifikohen për programin e lotarisë. "Edhe nëse ju keni mbaruar një pjesë të shkollës së mesme në sistemin pa shkëputje nga

puna dhe pjesën tjetër në sistemin me kohë të plotë, kjo diplomë nuk kualifikohet për programin e lotarisë. Diplomat universitare kualifikohen për programin e lotarisë së DV-së", thotë ambasada. Ndërkohë aplikantët që nuk përmblushin kriterin e arsimimit, duhet të përmblushin kriterin e përvojës në punë për dy vjet në një profesion që kërkon të paktën dy vjet trajnim apo përvojë brenda një periudhe pesëvjeçare menjëherë para aplikimit. Vetëm disa profesione specifike kualifikohen për programin e Vizave të Shumëllojshmërisë. "Për tu kualifikuar për një vizë të lotarisë mbi bazën e eksperiencës së punës, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klas-

ifikuar në Përgatitjen Profesionale Specifike (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart. Profesione të kualifikueshëm të DV-së janë të renditura në Bazën e të dhënave të Departamentit të Punës O\*Net Online Database", theksojnë ekspertët. **STATUSI MARTESOR** Të gjithë ata që do të bëjnë regjistrimin e DV-2020 duhet të plotësojnë edhe informacionin mbi statusin aktual martesor si: i/e pamartuar; i/e martuar dhe bashkëshorti/ja ime nuk është qytetare amerikane, apo me green card; i/e martuar dhe bashkëshorti/ja ime është qytetare amerikane, ose me green card; i divorcuar; i ve, ose i ndarë ligjrisht. Mospërfshirja e një bashkëshorti/eje ekzistuese në datën që do të dorëzoni aplikimin tuaj është shkak për squalifikim dhe refuzim të vizës. Nëse bash-

**UDHEZIMET**  
Të gjithë aplikantët e lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së.

**NUMRI I KONFIRMIMIT**  
Bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet, individët do të përzgjidhen rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Të gjithë aplikantët e DV-2020 duhet të shkojnë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të Konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi për DV-2020 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV.

këshorti/ja juaj është qytetar Amerikan apo Banor i Përhershëm i Ligjshëm, mos e përfshini atë tek aplikimi juaj. Një bashkëshort, i cili tashmë është një qytetar Amerikan apo një banor i ligjshëm i përhershëm nuk do të kërkojë dhe as nuk do t'i lëshohet një vizë DV. Ndaj, nëse zgjidhni opsionin "i martuar dhe bashkëshorti/ja ime është qytetare amerikane, ose me green card" tek aplikimi juaj, sistemi nuk do t'ju kërkojë të vendosni informacionin për bashkëshortin/en. Kandidatët duhet të renditin emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes, dhe shtetin e lindjes për të gjithë fëmijët e pamartuar nën moshën 21 vjeç në ditën e regjistrimit elektronik, pavarësisht nëse ata jetojnë apo jo me aplikuesin, apo s'kanë ndërmend ta shoqërojnë në

Shtetet e Bashkuara. **PËRZGJEDHJA** Përzgjedhja e aplikantëve bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet, individët do të përzgjidhen rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Të gjithë aplikantët e DV-2020 duhet të shkojnë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të Konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi për DV-2020 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të E-DV eëë.dvlottery.state.gov duke filluar nga 7 maji 2019 deri të paktën më 30 shtator 2020.



Implemented by **giz** German Development Cooperation GmbH

### GLOBAL PROGRAMME MIGRATION FOR DEVELOPMENT

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The Global Programme „Programme Migration for Development“ is commissioned by the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and is being implemented under the umbrella of the Centre for Migration and Development (CIM) – a joint operation of the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) and the International Placement Services (ZAV) of the Federal Employment Agency.

The overarching objective of the programme is to strengthen the development-relevant contributions of migrants in their countries of origin and improve the framework conditions for regular migration in selected partner countries.

One of the programme's component is "Migration and Reintegration Advice" under which the PME is operating an Information Centre for Migration, Vocational Education and Career Advice (Deutsches Informationszentrum für Migration, Ausbildung und Karriere – DIMAK Albania). The centre's target group are potential migrants as well as returning migrants from Germany. DIMAK Albania offers counselling services on perspectives of educational and professional development in Albania, as well as information and advice on possibilities and requirements of legal labour migration. In order to optimize the services of DIMAK for the target group, the project is intending to hire staff designated to advice potential migrants and especially returning migrants and to provide them with necessary information on migration as well as on social and professional reintegration. Next to the Centre itself, the PME is establishing an information and advice structure in Germany for migrants intending to return to their home country (Germany module). The advisor will cooperate closely with counterparts within the Germany module and within the bilateral portfolio of GIZ's country office.

**GIZ Office Albania seeks the following staff: Advisor - Migration and Reintegration**

#### A. Responsibilities:

The position holder will carry out advice giving services in the above mentioned frame to individuals seeking counselling and support, especially to migrants who have returned from Germany to Albania. He/She works in a team of advisors under the supervision of the Centre's National Coordinator. He/She exchanges with his/her counterpart in the Germany module in order to provide country-specific information to migrants intending to return from Germany. He/She works in a team and is in charge for reporting and monitoring of the project and provides related content. He/She cooperates with relevant counterparts within bilateral projects of GIZ and GIZ country office. He/She supports the National Coordinator in all activities of the Centre's project, in everyday occurrences and will fulfil tasks that will be delegated by the National Coordinator, Country Director and the Programme Coordinator of PME, based in Eschborn, Germany.

#### B. Tasks

The Advisor performs the following tasks:

##### Advice and Monitoring

- Provide project related information, counselling and advise to the visitors of the DIMAK (assistance, advice and guidance), face to face and virtual
- Implementing a client monitoring and tracking, following up on counselling talks
- Conducts research, review, prepares and forwards relevant reports and documents and helps update the office and project/programme website
- Works on impact monitoring, quality management, communication and documentation of the proper implementation of project plans and activities in close consultation with partner institutions.
- Supports with the necessary coordination processes to produce publications and materials in accordance with GIZ standards (corporate design, standards for content)
- Works in a team for reporting and monitoring of the project and provides related content.
- Supports with planning and execution of capacity-building activities, providing on-site support as needed
- Cooperates with relevant counterparts within bilateral projects of GIZ and GIZ country office.
- Participates in outreach activities, mobile advice, giving presentations to the target group

##### Crosscutting Tasks

- Assists the short-term experts assigned to project in completing their tasks including translation
- Preparation of appropriate input for project outputs as required by the project management and GIZ head office.
- Does backstopping to the project coordinator on the ongoing developments on the topic of migration advice in Albania and the activities of the government regarding this topic
- Provides general administrative support
- Updates the relevant folders of the GIZ Knowledge to facilitate access to key information for tenders such as project references, performance confirmations from clients etc.
- Carries out secretarial support and manages the filing system, follows up information flow and deadlines, prepares notification letters, archiving, agendas for meetings
- Prepare various written outputs, such as background papers, correspondence with governments, working papers, mission reports, presentations and ad hoc reports and participates in relevant meetings and conferences in the area of migration in Albania
- Takes on additional and ad-hoc tasks related to the profile describes assigned by the coordinator of PME in Albania
- Maintains the networking and cooperation with partner institutions and other relevant stakeholders (including non-governmental agencies, research institutes, business and other projects and donors), by ensuring good working relationships and sustainable cooperation towards the project's objectives.
- Ensures good communication and flow of information within GIZ and with other relevant actors
- Ensures good flow of information and coordination is established with all local and international partners

##### Required qualifications, competences and experience:

- Holds a university degree and has at least 4 years of relevant experience, particularly within international organisations
- He/she has relevant work experience in fields such as migration / advice of vulnerable groups / labor market / vocational training or another field that qualifies him/her for the occupation and has excellent communication and presentation skills
- Work experience with a public employer in the country of deployment would be an advantage
- Ability to support a multi-task, multi-discipline programme team
- Excellent working knowledge of MS products, particularly Word, Excel and PowerPoint
- Fluency in written and spoken English and Albanian. German language would be a strong asset
- Able to work in a team as well as independently
- Excellent social and communications skills

##### Contract conditions

- Full-time employment
- Project office in Tirana
- Duration: 2 years

Please forward your application until **28th of October 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de), including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**



Implemented by **giz** German Development Cooperation GmbH

### Regional Program "Conservation and Sustainable Use of Biodiversity at Lakes Prespa, Ohrid and Shkoder/Skadar (CSBL)"

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The regional program "Conservation and Sustainable Use of Biodiversity at Lakes Prespa, Ohrid and Shkoder/Skadar" (CSBL) assists Albania, Macedonia and Montenegro since 2014 in managing the natural resources of Lakes Prespa, Ohrid and Shkoder on a transboundary basis and in compliance with EU environmental and biodiversity protection targets – with particular focus on relevant European Union Directives, including the Water Framework Directive (WFD) and the Habitat and Birds Directives. The program also addresses issues related to sustainable fisheries. With strong cooperation among stakeholders within and among countries being crucial to achieving the program's objectives, a major focus is on water diplomacy and the institutionalization of transboundary cooperation.

The current project phase is January 2018 until June 2020.

**GIZ Office Albania seeks the following staff: Coordinator**

#### A. Responsibilities

The Coordinator is responsible for:

- Representing the CSBL program as national coordinator in Albania (with its three Lakes Prespa, Ohrid and Shkoder/Skadar), coordinate activities, services and events for all project thematic areas in Albania (Water Resources Management/Water Framework Directive, Bio-diversity Conservation, Sustainable Fisheries and Transboundary Cooperation)
- Advising national partners and relevant stakeholders on the implementation of the thematic areas Water Framework Directive, Biodiversity Conservation, Sustainable Fisheries and Transboundary Cooperation in Albania
- Drafting (sub-)programs, log-frames and ToR for national, regional and international experts
- Coordinating expert missions in Albania and follow-up on activities/results
- Cooperating with multiple stakeholders at local, national and regional levels, including Trans-boundary Water Commission, Lake/Fisheries Commissions, Ministries, Municipalities, Protected Area Administrations, Professional Associations, the Fisheries Management Organization of Albania as well as Non-governmental and Research Organizations
- Closely collaborating with CSBL national coordinators in Montenegro and Macedonia, re-spectively, and conduct joint activities
- Closely collaborating with the project's advisor on transboundary cooperation

**In this context, the Coordinator fulfils the following tasks:**

#### B. Tasks

##### Advising partner institution(s)

The coordinator

- assists and monitors the development and implementation of project/programme plans and activities in close consultation with counterparts,
- contributes to preparing and implementing the coordination process, joint project/pro-gramme activities and work at the regional level,
- supports and initiates the design, preparation and implementation of workshops, seminars and other events on issues connected with the project/programme's area of activity,
- develops and organises quality assurance measures and suggests necessary changes, im-provements and initiatives.

##### Networking and cooperation

- supports and initiates cooperation, regular contact and dialogue with relevant project government partner and non-governmental partners on all levels including cooperation with local communities, relevant organisations, non-governmental agencies and individuals in the project/programme environment and with other projects to improve and maintain good working relationships,
- assists with PR and communication work,
- communicates local interests and efforts, towards these and encourages sharing ideas and information for the benefit of the project/programme.

##### Knowledge Management

- ensures knowledge transfer to project/programme information,
- develops ready-to-use strategies and technical concepts, including guidelines, manuals and procedures,
- draws up reports and presentation documents,
- prepares appropriate input for various project/programme reports including annual reports, and contributes to the other reports required by the programme manager and GIZ Head Of-office,
- assists with research activities and studies on political issues which benefit joint pro-grammes.

##### Coordination tasks

- assists with general project planning and develops project concepts including preparation, organisation and moderation of planning exercises and their implementation, management, monitoring, quality management, evaluation, communication and documentation,
- coordinates relevant project activities at local level in consultation with the manager and in cooperation with the partners, both as regards to implementation and preparing organisational aspects,
- compiles the relevant information for joint activities and assignments,
- contributes to offer management on behalf of GIZ (e.g. offer preparation, impact monitoring, project progress review, reporting).

#### C. Required qualifications, competences and experience

- Advanced university degree in environmental sciences, natural/water resources management/hydrology, environmental law, environmental economics or related disciplines
- At least 7 years working experience in the field, of which 5 years in international settings
- Profound knowledge of water resources management in Albania and internationally
- Familiarity with relevant national environmental policies, strategies and legislation, in particular with respect to EU-compliant water resources management, biodiversity conservation and nature protection legislation, as well as inland fisheries
- High level of professionalism and cultural/political sensitivity
- Strongly developed diplomatic skills
- Strong analytical, planning and managerial skills
- Distinguished sense of responsibility and proactiveness
- High communicational, integrative and organizational skills – as well as interface competence
- Excellent spoken and written English and Albanian language skills
- Knowledge of German, Macedonian and/or Montenegrin would be an asset

#### D. Contract conditions

- Full-time employment
- CSBL project office in Tirana with duty travel within Albania and the region (Mainly Macedonia and Montenegro)
- Assignment period until June 2020

Please forward your application until **28th of October 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de), including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**

# DHUNA NË FAMILJE STATISTIKAT

Voltiza Duro

**S**hifra të frikshme zbardhen lidhur me dhunën në familje, ku vetëm një prej qendrave psiko-sociale ka pasur 212 raste të reja. Këto statistika zbardhen sot në "Gazetën Shqiptare" sipas raportit më të fundit të qendrës "Vatra" në Vlorë, e cila thekson se kanë marrë asistencë edhe 85 fëmijë të viktimave të dhunës. "237 viktimat të dhunës në familje, prej të cilave 212 raste të reja dhe 85 fëmijët e tyre të asistuar për herë të parë gjatë vitit 2017, konkretisht 190 vajza dhe gra, 9 djem dhe burra dhe 16 dhunues", - thuhet në raport. Nga 212 raste të asistuar për herë të parë gjatë vitit, 185 (87%) janë vajza dhe gra dhe 25 (13%) janë meshkuj. Vihet re një numër i lartë i përfutuesve të gjinisë mashkullore në dallim me vitin 2016.

## GRUPMOSHA MË E DHUNUAR

Gjatë vitit 2017 vihet re një përfshirje e të gjitha grupmoshave në ciklin e dhunës. Grupmosha më e prekur është 4-18 vjeç (30%), ndjekur nga grupmosha 26-35 vjeç, (21%). Në krahasim me 2016-ën vihet re një ndryshim, pasi është rritur numri i përfutuesve të mitur. Në lidhje me kategorinë e djemve dhe burrave, numrin më të lartë prej tyre e zë grupmosha 26-35 vjeç, duke qenë se në këtë moshë, ata kanë predispozitën më të lartë për të qenë dhunues dhe janë më të prirë për të kërkuar ndihmë në dallim me grupmoshat më të mëdha.


## LLOJET E DHUNËS

"Gjatë intervistave me 212 raste që kanë deklaruar se kanë pësuar dhunë dhe gjithashtu kanë ushtruar dhunë, në 70% të tyre është ushtruar më shumë se një lloj dhune dhe 30% kanë pësuar një lloj të caktuar dhune. Në shumicën e rasteve, dhuna fizike dhe ajo ekonomike janë shoqëruar edhe me lloje të dhunës psikologjike si: kërcënim, izolime, detyrime, zhvlerësim moral dhe social etj.", - theksohet në studimin e qendrës "Vatra". Shumica e përfutuesve që kanë kërkuar shërbime kanë qenë të martuara, konkretisht 91 përfutuese (43%). Më pas vijojnë përfutueset e divorcuara me 36% dhe numrin më të vogël e zënë përfutueset, të cilat kanë humbur bashkëshortët e tyre, vetëm 2% prej tyre. Krahasuar me vitin 2016, janë shuar rastet e viktimave të dhunës, të cilat janë beqare,


Qendra "Vatra": Grupmosha më e prekur, nga 4 deri në 18 vjeç. 212 viktimat të reja në një vit

# Baballarët "zhdëpin" në dru fëmijët, s'lejojnë bashkëshortet të punësohen

Raporti i 2017-ës: Shtohen rastet e dhunës në familje



Faksimille nga raporti i qendrës "Vatra"



## 30%

### TË MITUR TË DHUNUAR

Gjatë vitit 2017 vihet re një përfshirje e të gjitha grupmoshave në ciklin e dhunës. Grupmosha më e prekur është 4-18 vjeç (30%), ndjekur nga grupmosha 26-35 vjeç, (21%). Në krahasim me 2016-ën, vihet re një ndryshim, pasi është rritur numri i përfutuesve të mitur.

## 92%

### ZONAT URBANE

Shumica e përfutuesve të asistuar vijnë nga zonat urbane si Vlorë (92% e rasteve), Fieri, Berati, Lushnja etj., konkretisht 191 prej tyre (90%) dhe vetëm 10 e tyre (21 raste), vijnë nga zonat rurale si Selenica, Novosela, Rradhima etj.

## 60

### RASTE TË DHUNUAR NGA BABAI

Është vënë re një rritje e numrit të viktimave të dhunës, të cilat janë keqtrajtuar nga babai, konkretisht 60 prej tyre. Rreth 41% e viktimave të dhunës janë dhunuar nga partnerët e tyre si bashkëshorti, ish-bashkëshorti, bashkëjetuesi, partneri intim.

duke qenë se është rritur niveli i ndërgjegjësimit dhe janë më të hapura për të denoncuar dhunën që kanë pësuar.

## DHUNA NDAJ FËMIJËVE

Fëmijët e përfutuesve janë mbështetur me shërbime psikologjike, duke qenë se shumica prej tyre raportojnë se kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe fizike nga dhunuesi i nënës së

tyre. Gjithashtu, ata kanë qenë dëshmitarë të dhunës së ushtruar Dhuna emocionale ka qenë e pranishme pothuajse tek të gjithë fëmijët, dëshmitarë të dhunës në familje. "Është vënë re një rritje e numrit të viktimave të dhunës, të cilat janë dhunuar nga babai, konkretisht 60 prej tyre. Rreth 41% e viktimave të dhunës janë dhunuar nga partnerët e tyre si bashkëshorti, ish-

bashkëshorti, bashkëjetuesi, partneri intim. Ndër dhunuesit, përqindjen më të lartë e zë bashkëshorti, rreth 75%. Ndër përfutueset e intervistuar, 13 prej tyre raportojnë se janë dhunuar nga nëna, 15 prej përfutuesve raportojnë se janë dhunuar nga rrethi familjar, ku përfshihet vjehëri/vjehërra, kunata/kunati, xhaxhai ose mbesa (1 rast). 12 prej përfutuesve raportojnë

se janë dhunuar nga anëtarë të rrethit shoqëror si dhe të afërm familjarë, shoku, miq të një familjari. Vetëm 4 prej rasteve janë shprehur se janë dhunuar psikologjikisht nga institucionet dhe 4 të tjerë prej të panjohurve. Ndër 212 përfutues, 16 prej tyre kanë qenë dhunues. Vlen për t'u theksuar se gjatë eksplorimit të historisë së dhunuesve, edhe ata janë ish-viktima dhune, të cilët kanë kopjuar sjelljen e dhunshme", - thuhet në raport.

## ARSIMIMI

Niveli arsimor i viktimave të dhunës në familje është i ulët. Përqindjen më të lartë të nivelit arsimor e zë ai 8-9 vjeçar, konkretisht me 44% të rasteve. Përqindjen më të ulët e zë arsimi i lartë me 3% (8 raste). Përsa i përket gjinisë mashkullore, ashtu si vitin e kaluar, 80% e tyre i përkasin arsimit 8-9 vjeçar. Është e dukshme që viktimat e dhunës, ashtu si edhe dhunuesit, i përkasin një niveli të ulët arsimor.

## PUNËSIMI

Pjesa më e madhe e përfutuesve e rehabilitimit nga qendra "Vatra" nuk kanë asnjë profesion (61%). Pjesa tjetër e përfutuesve, të cilat kanë një profesion, (26%) janë trajnuar për profesione të tilla si robaqepësia dhe

parukieria. Profesione të tjera kanë qenë infermieria, mësuesia etj. Përsa i përket gjinisë mashkullore, gjithashtu numri më i madh i tyre nuk kanë asnjë profesion. Mungesa e punësimit përbën një nga faktorët kryesorë të vulnerabilitetit ndaj dhunës, gjë që shkakton një varësi ekonomike dhe sociale ndaj partnerëve që fitojnë të ardhura. Mbi 60% e përfutuesve raportojnë se nuk janë lejuar nga partneri i tyre që të punojnë. Pjesa tjetër e përfutuesve nuk janë punësuar, pasi nuk kanë asnjë profesion. Gjithashtu, duke qenë se nuk mbështeten nga asnjë person i afërt, nuk kanë mundësi për t'u kujdesur për fëmijët e tyre gjatë orarit të punës.

## ORIGJINA

Shumica e përfutuesve të asistuar vijnë nga zonat urbane si Vlorë (92% e rasteve), Fieri, Berati, Lushnja etj., konkretisht 191 prej tyre (90%) dhe vetëm 10% e tyre (21 raste) vijnë nga zonat rurale si Selenica, Novosela, Rradhima etj. Këto shifra nuk nënkuptojnë se dhuna është më e pranishme të përfutueset nga zonat urbane, por vërtetojnë faktin që përfutueset nga zonat rurale hasin vështirësi të shumta për të kërkuar ndihmë.

Grëfhet sociologia: Nuk është gabim të mos dish, por të mos duash të korrighesh

# Entela Binjaku:

## Gjendjet e një gruaje të tradhtuar krijojnë eufori dhe vetmi

"Vendi i sociologut në tregun e punës është ende i porealizuar"

Egla Xhemali

Ajo është kudo për të hedhur dritë mbi problematikat e shoqërisë. Entela Binjaku për "Gazeta shqiptare" ndan me ne ndryshimet që kanë pësuar familjet shqiptare, ku sipas saj, trendi më dominues në to është që të lindin sa më pak fëmijë, kjo për arsye të ndryshme që variojnë nga ato sociale për të shkuar te mungesat ekonomike. Të jesh "single mother" është e rehatshme vetëm për ato nëna, të cilat janë në gjendje t'ia dalin mbanë të vetme rritjes së fëmijëve. Këta të fundit sipas sociologes janë të varur nga ekрани nga ku influencohen për të krijuar modele false, që jo rrallëherë duan t'i ndjekin. Fëmijët duan përkujdesje e prindërit duhet të tregohen të kujdesshëm në rritjen e tyre. Në ditët e sotme "sulmi" nga teknologjia ka arritur të largojë të vegjlit nga lojërat, duke i bërë ata të mbyllur nga shoqëria. Mungesa e rreptësisë së prindërve mund të sjellë pasojë jo fort të pëlqyeshme, pasi fëmijët duke mos njohur asnjë lloj kujdesi, do thyejnë më vonë rregullt ligjore. Më tej, Entela na tregon për procesin e eksurbanizimit, që ka të bëjë me zhvendosjen e familjeve të pasura drejt periferive të banuara. Ajo thotë se ky ka qenë një realitet që shoqëritë e zhvilluara e kanë takuar dekada më parë, por që po përjetohet edhe tek ne, natyrisht në një shkallë më të ulët.

### Cili është trendi më dominues tek familjet shqiptare?

Urbanizimi i shoqërisë sonë është shoqëruar me ndryshimin e atyre vlerave që e kanë karakterizuar tradicionalisht. Aktualisht, familja shqiptare ka kaluar nga familja e zgjeruar që u jepte pjesëtarëve të saj qëndrueshmëri dhe siguri, drejt familjes bërthamë, ku nën një strehë jetojnë dy



prindërit dhe pasardhësit. Sot qytetari në Shqipëri ka më shumë pavarësi në vendimmarrje, që lidhen me jetën e tij, por nuk ka qëndrueshmëri dhe siguri. Ky ndryshim jo pak herë është reflektuar në hezitimin për të lindur edhe një fëmijë tjetër, gjë që është reflektuar tek numri i ulët i lindjeve. Në Shqipëri familjet e reja lindin çdo vit më pak fëmijë dhe këtë po e kryejnë edhe në një moshë më të avancuar. Arsyet sipas të cilave femra shqiptare sot vendos për të sjellë në jetë fëmijë janë të ndryshme nga ato tradicionale dhe janë shumë më të ndërlikuara sesa më parë. Të këto arsye mund të rendisim:

Kostoja e rritjes së një fëmije, mundësitë që i janë krijuar femrës shqiptare për shkolllim dhe për pozitë profesionale më të mirë. Statusi ekonomik i familjes, statusi martesor, përfshirë këtu divorcet në rritje, si dhe kërkesa për përputhshmëri mes jetës familjare dhe jetës profesionale ka sjellë familje më të vogla. Rënia e normës së martesës shoqëruar me rritjen e moshës mesatare në martesë të grave ka sjellë ndryshime edhe në strukturën familjare shqiptare. Kraha-

suar me 10 vite më parë, gratë shqiptare sot martohen relativisht tri vite më të mëdha. Situata e vështirë për strehim dhe punësim dhe mungesa e politikave nxitëse, miqësore e mbështetëse nga ana e shtetit për çiftet e reja i bën shpesh shumë çiftet të hezitojnë ose të shtyjnë moshën e lindjes së fëmijës së parë. Me vendimet e reja të qeverisjes aktuale për rritjen e kompensimit financiar për çdo fëmijë pas lindjes, ndoshta mund të presim edhe ndonjë ndryshim në këtë drejtim.

### Sa e rehatshme është jeta si një "single mother" në Shqipëri?

Shumica e njerëzve nuk dëshirojnë të jenë prindërit të vetëm, por ka një pakicë që vendos të jetë kështu, pa mbështetjen e ndonjë bashkëshorti apo partneri. Zakonisht këtë e bëjnë ato gra që janë në gjendje t'ia dalin mbanë vetëm rritjes së fëmijëve. Por, realiteti për pjesën më të madhe të nënave të ndara apo të pamartuara është i tillë. Ka një korrelacion të lartë mes lindjeve jashtë martesë dhe varfërisë apo privimeve sociale. Kategoritë e nënave të vetme sërish janë të ndryshme. Për shembull, ato që janë nëna të veja

kanë shtëpitë e tyre, por shumica e nënave të pamartuara jetojnë me qira. Kjo do të thotë se kufijtë që flasin për gjendjen e tyre reale janë të paqartë dhe të lëvizshëm. Sot 60 për qind e familjeve me një prind në botë vjen për shkak të ndarjeve apo divorceve.

### Çfarë bën një grua, burri i së cilës e kthen shtëpinë në "hotel"?

Një grua që ka një jetë martesore të tillë, nënkupton që vetë martesën nuk i kryen disa nga funksionet që ka për detyrë. Në këto kushte nuk realizohen as mbështetja emocionale, psikologjike, funksionet seksuale reduktohen, funksionet bashkëprindërore humbasin. Një grua në kushte të tilla ndjehet më e paplotësuar brenda një martesë të tillë edhe si grua, edhe si bashkëshorte. Mungesa e bashkëshortit bën që herë-herë të ketë eufori, herë kjo të ndërthuret me vetminë. Pëlqimi dhe respekti për njëri-tjetrin ia zë vendin mosbesimi dhe pasiguria. Në raste të tilla ajo ndihet e shkëputur nga bota e njëri-tjetrit, marrëdhëniet miqësore nisin e ndryshojnë. Me kalimin e kohës këto marrëdhënie mund të anojnë në drejtime të tjera. E kërkojnë



mbështetjen emocionale dhe sigurinë, për të cilën ka nevojë tek elementë jashtë-martesorë. Ka studiues që mendojnë se sot martesën ka pushuar së qeni kusht për realizimin e funksioneve seksuale të rregullta për të dy seksat, madje sipas tyre sot martesën nuk është më as baza për veprimtarinë ekonomike.

### Ku e kanë fokusin fëmijët në Shqipëri?

Sot fëmijët shqiptarë përballen me programe e kanale televizive që u kushtohen atyre. Kjo ka bërë që të rritet numri i fëmijëve të varur nga TV-të. Që në moshë të vogla fëmijët lihen me orë para ekranit, madje është bërë e modës që fëmija të ushqehet me ekranin para syve. Që në vitin 2011 "Akademia Amerikane e Pediatrisë" ka rekomanduar "ndalimin" e televizorit për fëmijët nën 2 vjeç dhe kufizimin deri në 2 orë për të gjitha moshat e tjera, me shpresën se redukton sedentarizimin dhe obezitetin. Fëmija ka nevojë të zhvillohet përmes lojës, përmes nxitjes neurosensoriale dhe socializimit me bashkëmoshtarët.

Koha e gjatë para televizorit po shoqërohet me probleme në sjellje, agresivitet, mungesë vëmendjeje dhe kjo gjë po takohet edhe në mjediset rurale. Kjo kohë e gjatë para ekranit po krijon modele false të fëmijëve dhe modele që jo gjithmonë janë të mira. Por, nëse nuk punohet me të rriturit, vështirë të kihet rezultat me fëmijët. Së pari, të rriturit duhet të heqin dorë nga krenaria se nuk kanë nevojë për këshillat e të tjerëve. Nuk është gabim të mos dish, gabim është të mos duash të korrighesh. Fëmija është një njeri në proces formimi dhe si i tillë, ai ka nevojë për edukim dhe kujdesje. Tek secili prej nesh, zakoni është një forcë e madhe për të vepruar, ndaj dhe një edukim cilësor është zakoni më i mirë që mund të marrim në fëmijëri. Për këtë arsye, sfida më e madhe me fëmijët mendoj se është edukimi i tyre. Në këtë kohë që jetojmë fëmijët janë të "sulmuar" nga mjetet teknologjike që janë shumë tërheqëse për ta, por që marrin shumë nga koha që i duhet kush- →


## Enca bën twerk në mes të Parisit, zbuloni si reagojnë kalimtarët

Ajo ka ditë që po relaksohet në Paris, vend në të cilin do të festojë edhe ditën e lindjes. E kemi fjalën për Encën. Bukuroshja i paralajmëroi të gjithë fansat e saj se do të gjendej për ditën më të rëndësishme për të në kryeqytetin e të dashuruarve së bashku me motrën. Duket se këngëtarja po i shijon pafund këto ditë pritjeje. Së fundmi, ajo ka publikuar video ku shfaqet në mes të qytetit, teksa tund të pasmet dhe përshëndet fansat. Kjo nuk hera e parë që Enca tërheq vëmendjen teksa shëtit nëpër botë.



## Më në formë se kurrë! Zajmina provokon fansat me foton e fundit

Zajmina Vasjari është rikthyer fuqishëm me postimet e saj në rrjetet sociale. Ajo pa frikë renditet ndër mamatë e reja më seksi. Kjo thellohet edhe me shumë nga postimi i saj i fundit, ku me fustanin e kuq nxjerr në pah trupin me linjat perfekte dhe duket më sensuale se kurrë. Këngëtarja gjithmonë ka qenë në topformë dhe pas lindjes së Khlohe është edhe më mirë. Ende nuk dihet nëse bukuroshja do ketë ndonjë projekt muzikor, duke qenë se i është dedikuar tërësisht biznesit të saj.



← tuar edukimit. Sot në një fëmijë ndodhet nën hipermbrojtje nga ana e prindit, ose nga mungesa e rreptësisë nga ana e tyre. Ka psikologë që nuk e rekomandojnë që prindërit të jenë shokë në lojërat e fëmijëve dhe të harrojnë funksionin edukues. Mungesa e rreptësisë dhe e rregullave do ta çojë fëmijën drejt një zone ku ai gjithmonë do të ketë prirjen të shkelë rregullat ligjore dhe të mos ketë prirjen për të dhënë shpjegime. Fëmija duhet të jetë i aftë të dallojë qartë të mirën nga e keqja. Universiteti i 'Essex'-it ka bërë një studim që ka zgjatur 6 vjet dhe që ka marrë në shqyrtim 15 mijë fëmijë të moshave 13-14 vjeç. Nga ky studim u pa se fëmijët që kishin marrë një edukim të rreptë në familje ishin më këmbëngulës dhe më me vetëbesim. Edhe pse në jetën si i rritur duket se

vendimet i marrim në mënyrë të pavarur, sërish edukimi që ka marrë në shtëpi është një ndër faktorët me ndikim të madh në këtë proces. **Pyetja më shpeshtë që të drejtojnë sot si sociologe?** Në vitet e para pas studimit, pyetja më e shpeshtë ka qenë: Po ç'a pune mund të bësh? Ku mund të punojë një sociolog? Kjo pyetje më është përsëritur besoj deri nga viti 2010. Në këto vitet e fundit më pyesin më shumë për dukuritë e caktuara. Për shembull, shumë pyesin kur degjojnë një histori incesti. "Pse vërtetë thua ka ndodhur?". Kjo tregon se ndoshta shoqëria ka nisur të njihet me dobishmërinë e profesionit tonë dhe për këtë, një meritë shumë të madhe ka media, të cilës do t'i jem gjithmonë mirënjohëse. Por vendi i sociologut në tregun e punës është ende i pareali-

zuar. **Alternativa që ke për kthimin e vëmendjes tek moshat e thyera?** Ndryshimet në familjet shqiptare kanë prekur edhe të moshuarit, të cilët në mënyrë tradicionale kanë jetuar në familje. Tani të moshuarit shqiptarë po përballen me vetminë, izolimin, braktisjen ose institucionalizimin. Sot duhet të pranojmë edhe rritjen e një kategorie që njihet si "mosha e katërt", e thënë ndryshe "më të moshuarit e të moshuarve", pra mbi 80-vjeçarët. Me këtë po jetojmë edhe rënien e një tjetër miti, si shoqëria me moshë të re dhe madje, edhe më të re në një Evropë që vijonte të plakej. Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian pikërisht duke u nisur nga shqetësimi për zhvillimet e popullsisë e shpalli vitin 2012 si vitin e "Vitin evropian për solidaritetin mes brezave dhe për plakje aktive". Qëllimi ishte të rritte ndërgjegjësimin në opinionin publik dhe në qeveritë e këtyre shteteve ndaj masave për një popullsi që po plakej dhe që meritonte mundësi për një jetë të shëndetshme. Në një studim të disa viteve më parë OKB-së deklaroi se Suedia është vendi ku një i moshuar jeton më mirë dhe Afganistani vendi ku një i moshuar jeton më keq. Kjo renditje e bazonte në nivelin e të ardhurave, cilësinë e shërbimit shëndetësor,

kushtet mjedisore në të cilat jetojnë. Ndaj, nëse duam të japim alternativa për kthim të vëmendjes, le të shohim si janë të moshuarit shqiptarë në këto drejtime. Duke parë realitetet e reja demografike në të cilat po gjendeshin, shtete të ndryshme kanë ndërmarrë edhe politika specifike. Ne duhet të përmbushim ato detyrime që marrim përsipër kur nënshkruajmë një partneritet apo një angazhim ndërkombëtar, sikundër duhet të tregojmë respekt për ato vlera që na kanë karakterizuar tradicionalisht,

siç është solidariteti me brezat dhe kujdesi për më të moshuarit. Deri 5 vjet më parë numri i të moshuarve që merrnin shërbime në qendra rezidenciale ditore dhe joditore nga sektori publik, jopublik dhe i organizatave jofitimprurëse ishte thuhajse 1000. Sot ky numër mund të jetë më i lartë, por sërish qendrat nuk gjenden kudo ku nevojiten dhe numri i përfituesve është më i vogël se i atyre që kanë nevojë. Alternativë janë shërbimet sociale shtetërore reale dhe të prekshme, shërbime në komunitet, pranë dhe në

ndihmë të njerëzve në nevojë, por që janë edhe të moshuar njëkohësisht. Për këtë do të duheshin politika punësimi dhe programe kundër varfërisë, të atilla që të ndikonin edhe në mënyrën e të jetuarit të një të moshuari. **Konflikti më i fortë me realitetin në periferi të qendrave të banuara?** Periferitë aktualisht janë thuhajse të zbrazura ose po zbrazen, ose janë të shpëputura nga pjesa tjetër e qytetit. Jetojnë nënkulturat e zonave që i popullojnë, prekin fare pak shërbimet publike dhe aspak thuhajse jetë kulturore. Vendi e shpresës me kalimin e kohës e ka zënë pasiguria dhe mungesa e perspektivës se do të ndryshojë ndonjëherë cilësia e jetës. Konflikti buron nga përplasjet, pamundësitë, pabarazitë dhe këto në periferi të zonave urbane nuk mungojnë. Të rinjtë janë ata që e pasqyrojnë këtë realitet më së shumti. Mjaft të shohësh edhe në institucionet e izolimit në vend, ku të rinjtë janë shumicë dhe ata që vijmë nga periferitë zënë një pjesë të madhe. Por, shoqëria po njih edhe një proces tjetër, që është ai i eksurbanizimit, pra i zhvendosjes së familjeve të pasura drejt periferive të banuara. Ky ka qenë një realitet që shoqëritë e zhvilluara e kanë takuar dekada më parë, por që po përjetohej edhe tek ne, sigurisht në një shkallë më të ulët.



**Scott: Ideja e shteteve etnikisht të pastra, e rrezikshme**

**Mesiç: Arkitektura europiane e kompletuar, ndryshimi i kufijve çon drejt katastrofës**

**K**yle Scott, ambasadori amerikan në Serbi foli për normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit si dhe për vijat e kuqe të SHBA-ve. "Në SHBA nuk ekzistojnë vijat e kuqe apo kufizimet për atë se duhet bërë e çfarë jo, thjesht ua kemi lënë vendeve të vendosin objektivat, kurse SHBA-të do të jenë të hapura që t'i shqyrtojnë", tha ambasadori i SHBA-ve. Teksa u ndal te fakti për normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës ai tha se jo domosdoshmërisht SHBA do të pranohet çdo lloj marrëveshje. "Ideja e shteteve etnikisht të pastra në Ballkan është joreale dhe e rrezikshme. Kudo që vihet vija e kufirit, pres që të dy shqëritë të jenë multietnike", ka shtuar Scott. Ndërkaq ish-presidenti kroat, i cili njihet edhe si mik i madh i Kosovës, Stipe Mesic, ka folur në lidhje me idenë e korigjimit apo ndryshimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Në një intervistë

**KYLE SCOTT**

"Në SHBA nuk ekzistojnë vijat e kuqe apo kufizimet për atë se duhet bërë e çfarë jo, thjesht ua kemi lënë vendeve të vendosin objektivat, kurse SHBA-të do të jenë të hapura që t'i shqyrtojnë", tha ambasadori i SHBA-ve.

shteteve etnikisht të pastra në Ballkan është joreale dhe e rrezikshme. Kudo që vihet vija e kufirit, pres që të dy shqëritë të jenë multietnike", ka shtuar Scott. Ndërkaq ish-presidenti kroat, i cili njihet edhe si mik i madh i Kosovës, Stipe Mesic, ka folur në lidhje me idenë e korigjimit apo ndryshimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Në një intervistë

shteteve etnikisht të pastra në Ballkan është joreale dhe e rrezikshme. Kudo që vihet vija e kufirit, pres që të dy shqëritë të jenë multietnike", ka shtuar Scott. Ndërkaq ish-presidenti kroat, i cili njihet edhe si mik i madh i Kosovës, Stipe Mesic, ka folur në lidhje me idenë e korigjimit apo ndryshimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Në një intervistë

për "Der Standard", Mesic ka thënë se një ide e tillë nuk mund të konsiderohet si e mirë, pasi siç thotë ai, një gjë e tillë mund të shkaktojë një katastrofë dhe, gjithashtu, një luftë të re. "Kjo nuk është një ide e mirë, sepse arkitektura e Evropës është kompletuar me pavarësinë e Kosovës. Gjithçka tjetër mund të dërgojë drejt një katastrofe të re, një luftë të re. Luftërat në Evropë gjithmonë kanë filluar me arsyetimin se shtetet dëshironin t'i

mbronin pakicat e tyre në vendet e tjera. Por, kjo ishte vetëm një arsye, pasi qëllimet e tyre ishin territore", ka thënë ai. Sipas tij, një hapje e kufijve do të mund të ishte një ide më e mirë, ngaqë serbët dhe shqiptarët nuk do të shqetësoheshin se në cilin shtet jetojnë. "Një francez mund të jetojë në të dy anët e kufirit falë ligjeve të njëjta dhe të barabarta. Nëse hapim kufijtë, nuk do të kishte rëndësi për një shqiptar apo serb se në cilën anë do të jetojnë", thotë ai. Mesic po ashtu foli edhe për të ashtuquajturit kufij etnik mes shqiptarëve dhe serbëve, për të cilët tha se një ide e tillë është e vjetër dhe nacionaliste. Siç thotë ai, nacionalizmi detyrimisht dërgon në fashizëm, ideologji që sipas Mesic duhet të ndalohet në Evropë.

**SHKURT**

**Trump kërcënon se do të dërgojë ushtrinë në Meksikë**

Presidenti Donald Trump ka kërcënuar se do të dërgojë ushtrinë për të mbyllur kufirin jugor të SHBA-së me Meksikën, nëse autoritetet meksikane nuk marrin masa për të ndaluar fluksin e emigrantëve. Në një postim në rrjetet sociale, Trump akuzoi qeveritë e Guatemalës, Hondurasit dhe El Salvadorit që kanë lejuar kalimin e një numri të madh emigrantësh duke shkuar drejt vendeve qendrore të Shteteve të Bashkuara. Kreu i Shtëpisë së Bardhë u shpreh se do t'i kërkojë Meksikës që të ndalojë fluksin e refugjatëve të paligjshëm. Nëse qeveria meksikane nuk merr masa, Trump tha se do të dërgojë ushtrinë në kufirin jugor.

**Putin: ISIS po vret nga 10 pengje evropiane e amerikane në ditë**

700 pengjet e kapura në Siri nga terroristët e Shtetit Islamik përfshijnë qytetarë amerikanë dhe evropianë dhe po vriten 10 persona në ditë, tha presidenti rus Vladimir Putin, duke kritikuar forcat amerikane për dështimin "katastrofik". Terroristët e Shtetit Islamik "kanë dorëzuar ultimatumet dhe kanë bërë kërkesa të caktuara, duke kërcënuar se do të vrasin dhjetë vetë çdo ditë", tha kreu rus, duke shtuar se pengmarrësit tashmë kanë filluar të realizojnë kërcënimet e tyre duke ekzekutuar dhjetë pengje dy ditë më parë. "Kjo është jo vetëm tmerrshme, është një katastrofë", tha Putin, duke shtuar se forcat amerikane që pretendojnë të kontrollojnë zonën rreth bregut lindor të lumit Eufrat, duke u mbështetur në forcat e armatosura kurde në terren, qëndrojnë të dukshëm të heshtur rreth krizës. "Disa qytetarë amerikanë dhe evropianë janë midis pengjeve", paralajmëroi presidenti, duke shtuar se "të gjithë heshtim ... sikur të mos ketë ndodhur asgjë". Terroristët e Shtetit Islamik vazhdojnë të zgjerojnë praninë e tyre në zonë", tha ai.

**Bosnjë, sherr masiv mes emigrantëve**

Një sherr masiv mes disa emigrantëve të huaj ka ndodhur ditën e djeshme në Bosnjë Hercegovinë. Mediat vendase raportuan se sherrit ka ndodhur në afërsi të aeroportit të Sarajevës, pranë para zyrës së punës për shtetasit e huaj. Mësohet se në sherr janë përfshirë mbi 30 emigrantë, ku janë përdorur edhe objekte të forta. Radio Sarajeva ka arritur të sigurojë videon teksa shihen të rinjtë duke u grushtuar e shqelmuar në prezencë të dhjetëra kalimtarëve të rastit. "Është e vështirë të përshkruhet me fjalë për atë çfarë ka ndodhur. Gjithçka duke qetë, kur papritmas u krijua një situatë kaotike", ka deklaruar gazetari që ishte në vendin e ngjarjes.

**Lista serbe kundër FSK, Ramush Haradinaj falënderon KFOR dhe NATO-n**

**Zyrtare/ Kuvendi miraton krijimin e ushtrisë së Kosovës**

**Vuçiç: Largimi i UNMIK na detyron të mbrojmë njerëzit tanë**

**D**eputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar të tre projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri. Projektligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës është miratuar me 96 vota pro. Ky projektligj rregullon kushtet e përgjithshme të shërbimit në FSK si një shërbim i ndërtuar mbi bazën e parimit të llogjshmërisë, profesionalizmit, komandës, disiplinës, respektit, nderit, ruajtjes së informacionit, komunikimit, jo diskriminimit dhe mundësive të barabarta, paanshmërisë politike, transparencës dhe llogaridhënies. Projektligji përcakton kriteret e përgjithshme për shërbim, parametrat e shërbimit, kohëzgjatjen e shërbimit, zhvillimin e karrierës, ndërprerjen e shërbimit, statusin e pjesëtarit të FSK-së, të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve dhe çështje të tjera në kuadër të shërbimit në FSK. Më herët u votuan me 101 vota pro projektligji për krijimin e Ministrisë së Mbrojtjes si dhe me 98 vota projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Lista serbe është shprehur sërish kundër ushtrisë së Kosovës. Ditën e sotme, teksa në Kuvendin e Kosovës diskutohet projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes, deputeti i Listës Serbe, Igor Simić tha se shqiptarët dhe serbët nuk kanë nevojë për militarizim e për

**RAMUSH HARADINAJ**

"Kosova është një shtet, shoqëri multietnike, i kemi dallimet tona, jemi mësuar të jetojmë në diversitet dhe gjithashtu duke respektuar njëri-tjetrin. Duhet të jeni krenarë për atë që keni arritur si NATO, si KFOR në Kosovë dhe rajon", - tha Haradinaj.



Parlamenti i Kosovës

**ALEKSANDAR VUÇIÇ**

"Çfarëdo lloj veprimi mund të ndërmarrë Serbia në Kosovë. Kërcënimi i tij vjen pas thirrjes së bërë nga ambasadorja amerikane në OKB, Nikki Haley, për të përpunuar strategjinë e daljes së misionit të OKB-së në Kosovë, të njohur si UNMIK", - tha presidenti serb.

luftë. "Të rinjtë e Kosovës nuk po ikin se nuk ka Ushtri, por, sepse nuk ka perspektivë. Më mirë është që 150 milionë euro të planifikuara për tri vitet

e ardhshme të shkojnë në zhvillim ekonomik se sa në ushtri. Kjo nuk është në interes as tonin dhe as të qytetarëve të Kosovës dhe për këtë largo-

hem nga seanca. Krijimi i ushtrisë është dhe kundër të rezolutës 1244, Marrëveshjes së Kumanovës dhe ndërkombehtarët kanë theksuar se pa ndryshimet Kushtetuese nuk mund të krijohet", tha Simić. Pas miratimit të Ushtrisë së Kosovës sot nga Kuvendi, kryeministri Ramush Haradinaj falënderoi të gjithë pjesëtarët e KFOR-it, NATO-s, që i kanë shërbyer paqes në këtë shtet. Kryeministri Haradinaj theksoi se Kosova respekton dhe nderon sakrificën e burrave dhe grave dhe në veçanti të atyre që kanë humbur jetën duke shërbyer, prandaj shteti ynë gjithmonë do t'i përkujtojë ata si njerëz që kanë ndihmuar, që sot të jetojnë në paqe. "Kosova është një shtet, shoqëri multietnike, i kemi dallimet tona, jemi mësuar të jetojmë në diversitet dhe, gjithashtu, duke respektuar njëri-tjetrin. Duhet të jeni krenarë për atë që keni arritur si NATO, si KFOR në Kos-

ovë dhe rajon", -tha Haradinaj. Ndërsa presidenti serb Aleksandar Vuçiç tha se do të mërkuar se thirrja e SHBA për tërheqjen e misionit paqeruajtës të OKB-së nga Kosova do ta linte Serbinë pa zgjidhje tjetër përveçse të mbronte njerëzit e saj në Kosovë. Vuçiç nuk tha konkretisht se çfarë lloj veprimi mund të ndërmarrë Serbia në Kosovë. Kërcënimi i tij vjen pas thirrjes së bërë nga ambasadorja amerikane në OKB Nikki Haley për të përpunuar "strategjinë e daljes" së misionit të OKB-së në Kosovë të njohur si UNMIK. Presidenti Vuçiç tha se largimi i UNMIK-ut dhe formimi i mundshëm i ushtrisë së Kosovës, nuk do t'i linte Serbisë asnjë zgjedhje tjetër, por të mbronte vendin dhe njerëzit e saj, siç u shpreh ai. UNMIK u vendos në Kosovë në vitin 1999, pas ndërhyrjes së NATO-s për të frenuar masat e ashpër të Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës.

**FENOMENI I VEÇANTË NË JAPONI, PAS TAJFUNEVË LULËZJOJNË QERSHITË**

Tajfunët e shpeshtë që kanë goditur Japoninë prej verës deri në javët e fundit, kanë favorizuar lulëzimin e qershëve. Nga zona jug-perëndimore e Kyushu në pjesën veriore të Hokkaido, ekspertët janë njoftuar për prezencën e luleve në pemë, një fenomen që zakonisht ndodh në Japoni në pranverë.



FOTOLAJM

Mediat gjermane: Ja "viktima" e parë e Marrëveshjes së Prespës

# Kotzias jep dorëheqjen, zbardhet telefonata Tsipras-Zaev

## Xhaferri: Largimi i ministrit s'ka lidhje me paktin

Vetëm dy ditë pas dorëheqjes së ministrit të Jashtëm grek Nikos Kotzias, mediat greke zbardhën telefonatën që ka bërë kryeministri Alexis Tsipras me homologun e tij Zoran Zaev. Ky i fundit mësohet se i shprehu kurajë kryeministrit grek duke theksuar vështirësitë e mëdha e të përbashkëta të procesit çdo hap e më të vështirë, por që synon në stabilizimin e dy vendeve në një rajon të ri ballkanik. Nga ana tjetër, ish-ministria e Jashtëm Dora Bakojanis deklaroi në Skai se me marrëveshjen e Prespës, Kotzias "iu dha identitetit maqedonas shqiptareve të Maqedonisë. Baza e marrëveshjes me referim në Republikën e Irlandës është baza e irredentizmit. Demokracia e Re është gati për rishikim të marrëveshjes nga zero, me qëndrim realist dhe largpamës". Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Talat Xhaferri nuk pret se dorëheqja e shefit të diplomacisë greke Nikos Kotzias mund të ketë ndikim në marrëveshjen e arritur mes Shkupit dhe Athinës zyrtare lidhur me emrin e Maqedonisë. "Ministri i Punëve të Jashtëm ka dhënë dorëheqje për aspektin e qasjes që kanë pasur brenda qeverisë me pjesën opozitare, bile edhe me pjesën e koalicionit që janë brenda përbrenda qeverisë, që nënkupton se të dy palët kanë bërë kompromis për diçka, dhe vlerësimi është që askush nuk mundet për një periudhë goxha të gjatë, nuk mundet të vijë në një marrëveshje të re të mundshme dhe të pretendojë që do jetë edhe ma e mira". Duke folur për tensionin në parlament mes mazhorancës dhe opozitës, kryeparlamentari Xhaferri u shpreh se është



Kryeministri i Greqisë, Alexis Tsipras dhe ai i Maqedonisë, Zoran Zaev

### TALAT XHAFFERRI

"Ministri i Punëve të Jashtëm ka dhënë dorëheqjen për aspektin e qasjes që kanë pasur brenda qeverisë me pjesën opozitare, madje edhe me pjesën e koalicionit që janë brenda përbrenda qeverisë, nuk mundet të vijë në një marrëveshje të re të mundshme dhe të pretendojë që do jetë edhe më e mira", - tha Xhaferri.

optimist se palët do të gjejnë gjuhë të përbashkët. Sipas tij zgjedhjet e para kohshme nuk janë zgjidhje. "Ka deputetë të shqetësuar për fatin e popullit që jeton këtu, për fatin e vendit që duhet ta ketë statutin që duhet ta ketë në nismat në organizmat euroatlantike". Këto komente Kryetari i Kuvendit Talat Xhaferri i bëri në emisionin Klan Debate. Përndryshe, nesër ku-

vendi në Shkup duhet të vazhdojë seancën ku duhet të votohen ndryshimet Kushtetuese. Nga ana tjetër një reagim e kanë dhënë dhe mediat e huaja lidhur me këtë largim. Kanë qenë pikërisht mediat gjermane, të cilat kanë komentuar gjërësisht dorëheqjen e ministrit të Jashtëm të Greqisë Nikos Kotzias. Media gjermane "Spiegel" shkruan se

dorëheqja e Kotzias ka ardhur si pasojë e rolit që kanë luajtur politikanët grekë në negociatat për emrin e Maqedonisë. Detyrat e ministrit të Jashtëm të Greqisë do t'i marrë përsipër kryeministri Alexi Tsipras, njoftoi zyra e tij. Arsyja e grindjes brenda kabinetit qeveritar është pikërisht për emrin e Maqedonisë, thotë "Spiegel". Kotzias akuzoi ministrin e Mbrojtjes Panos Kamenos për minimin e marrëveshjes së arritur mes dy vendeve. Kurse mediat tjetër gjermane "Neue Zürcher Zeitung" e cilëson Nikos Kotzias si "viktimën e parë" të Marrëveshjes së Prespës, mes Greqisë dhe Maqedonisë për ndryshimin e emrit të kësaj të

fundit. "Ka pasur një polemikë të madhe në koalicionin qeverisës të Greqisë mbi propozimin për zgjidhjen e konfliktit të mbartur prej dekadash. Çarjet bëhen gjithnjë e më të thella. Konflikti brenda qeverisë greke lidhet me kompromisin mbi emrin, duke shkaktuar "viktimën" e parë", - shkruan gazeta gjermane.

"Ka pasur një polemikë të madhe në koalicionin qeverisës të Greqisë mbi propozimin për zgjidhjen e konfliktit të mbartur prej dekadash. Çarjet bëhen gjithnjë e më të thella. Konflikti brenda qeverisë greke lidhet me kompromisin mbi emrin, duke shkaktuar "viktimën" e parë", - shkruan gazeta gjermane.

### GAZETA GJERMANE

"Ka pasur një polemikë të madhe në koalicionin qeverisës të Greqisë mbi propozimin për zgjidhjen e konfliktit të mbartur prej dekadash. Çarjet bëhen gjithnjë e më të thella. Konflikti brenda qeverisë greke lidhet me kompromisin mbi emrin, duke shkaktuar "viktimën" e parë", - shkruan gazeta gjermane.

### SHKURT

**Brexit, May s'po gjen gjuhën me Bashkimin**

#### European

Shkëputja e Britanisë së Madhe nga BE mund të shtyhet deri në fund të vitit 2021. Kryeministria Theresa May nuk arriti të gjejë një zgjidhje në bisedimet me 27 liderët e vendeve anëtarë, të mërkurën në Bruksel. Palët janë të ndara sa i përket kufirit me Republikën e Irlandës. May ftoi liderët europianë të përmbyllin Brexitin në afatin aktual, dhjetorin e vitit 2020, por zgjidhja mbetet larg. Shefes së qeverisë britanike do t'i duhet të përballot edhe me presionin e brendshëm tashmë, pasi 1 vit më shumë në BE, do të i vitit thotë më shumë taksa dhe varësi tregtare nga BE.

**Alienë në Tokë? Ish-rreshterit amerikan i ndodh tragjedia**

Karl R. Wolfe, ish-rreshter i Forcave Ajrore amerikane, i cili pretendonte se kishte para foto sekrete të NASA-s të një baze aliene në Hënë, ka humbur jetën. 74-vjeçari ndërroi jetë në një aksident tragjik që ndodhi më 10 tetor në New York. Ai po udhëtohe me biçikletë kur u përplas në pjesën e pasme të një traktori. Ish-rreshteri u dërgua në spital, por nuk mundi të mbijetonte si pasojë e plagëve të rënda. Në vitin 2001, Karl R. Wolfe u bë i njohur në media pasi pretendonte se kishte parë prova fotografike të një strukture aliene në pjesën anësore të Hënës. Sipas pretendimit të tij, struktura ishte një ndërtesë e madhe me shumë persona të huaj brenda saj, të veshur me rroba civile dhe të shoqëruar nga përktues. Kjo ishte një pamje e çuditshme, sipas tij. Pasi u largua nga shërbimi në Forcën Ajrore, ish-rreshteri punoi në Universitetin e Buffalo duke pasur dy diploma, atë të Antropologjisë Sociale Kulturore dhe të Inxhinierisë Elektronike. Karl R. Wolfe nuk u martua asnjëherë dhe nuk kishte fëmijë.

**I hoqën fëmijën nga barku gruas shtatzënë, arrestohet çifti**

Një çift në Brazil është arrestuar, pasi i kanë hequr fëmijën një gruaj shtatzënë. Trupi i Mara Cristiana da Silva u gjet i lidhur pas një peme dhe stomaku i saj ishte prerë për t'i nxjerrë foshnjën. Da Silva ishte tetë muajsh shtatzënë në kohën që çifti ka kryer krimin. Ngjarja ka ndodhur në juglindje të Brazilit. Angelina Rodrigues, e cila ka kryer krimin së bashku me burrin e saj ëndërronte të kishte një vajzë të vogël, kanë thënë njerëzit e afërm të viktimës, pasi kanë marrë vesh për ngjarjen e rëndë. Mjekët në ndiqnin gruan filluan të shqetësoheshin, pasi ajo nuk po shkonte më për kontroll. Pas zbulimit të ngjarjes, policia arrestoi zonjën Da Silva si dhe bashkëshortin e saj.

## Hristijan Mickoski: Marrëveshja e Prespës ka vdekur

### Kreu i opozitës maqedonase nuk bën kompromise: Të ndërpritet procedura parlamentare

Hristijan Mickoski, kreu i opozitës maqedonase thotë për Deutsche Wellen se partia e tij nuk do ta mbështesë marrëveshjen historike për emrin e Greqinë, që do të hapte rrugën e integritimit të Maqedonisë për në NATO e BE. Në kohën që parlamenti i Maqedonisë ka hyrë në ditën e tretë të debatit për të aprovuar apo jo marrëveshjen për ndryshimin e emrit, rezistenca e partisë opozitare nacionaliste, VMRO-DPMNE është ashpërsuar. Kryetari i kësaj partie, Hristijan

Mickoski tha për Deutsche Wellen, se ai e konsideron marrëveshjen me Greqinë "të vdekur" dhe i kërkoi qeverisë të ndërprisë procedurën parlamentare. Kryeministri maqedonas, Zoran Zaev aktualisht është duke punuar fort për të arritur shumicën me dy tretat që do të ndryshonte emrin e vendit në Maqedonia e Veriut, e që do të sillte ecjen përpara në integrimin në BE dhe anëtarësimin në

NATO. Por Zaevit i duhet të bindë të paktën 10 deputetë të opozitës në një parlament prej 120 deputetësh. I pyetur, nëse ka ndonjë shans që ai dhe kryeministri, Zoran Zaev të arrijnë një marrëveshje, Mickoski u tregua i pakompromis. "Edhe ky është një shans, pra të arrihet në konkluzionin, se marrëveshja ka vdekur". Mickoski dhe partia e tij vendosën të abstenonin votën për referendumin e

fundit për ndryshimin e emrit të Maqedonisë, duke e bërë kështu të pamundur arritjen e numrit të duhur të pjesëmarrjes së nevojshme 50%. Asistenti i Sekretarit Amerikan të Shtetit për Çështjet Europiane dhe Euroaziatike, Wess Mitchell ishte të martën nga të fundit pas shumë politikaneve të BE-së dhe SHBA-së që e nxisin Mickoskin të lëvizë nga pozicioni i tij. "Nuk do të jetë si një habi

për ju, që ne kemi qenë të zhgënjyer me pozicionet e liderëve të VMRO-DPMNE-së në lidhje me referendumin dhe hapat në parlament për të ndryshuar kushtetutën", shkroi Mitchell në një letër personale për Mickoskin, që u bë publike nga ambasada amerikane në Shkup. Letra ishte pak a shumë e njëjtë me kreun e partisë popullore europiane, Joseph Daul, i cili javën e kaluar deklaroi se ishte i zhgënjyer me qëndrimin e VMRO-DPMNE-së. Të dy politikanët i thanë Mickoskit se ai dhe partia e tij do të mbajnë përgjegjësinë për dështimin e marrëveshjes së emrit.

## DOKUMENTI LETRA E TEFTA CAMIT

Ekskluzive/ Zbulohet letra e Tefta Camit në nëntor të 1974, dërguar Enverit dhe Hysni Kapos

# Dokumenti: Kur Tefta Cami i ankohej Enverit e Hysni Kapos për Haxhi Lleshin

*Letra e Tefta Camit: Shoku Enver, jam e bindur tashmë se shoku Haxhi Lleshi, pas krahëve kërkon të krijojë opinione kundër meje*

Dashnor Kaloci

Diku nga viti 1973-'74, me rastin e festave jubilarë të 30-vjetorit të formimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe "çlirimit të vendit nga pushtuesit nazi-fashistë", festa, të cilat do të përkujtoheshin me mjaft pompozitet dhe paradë ushtarake madhështore, me porosi nga Komiteti Qendror i PPSH-së, në disa rrethe të Shqipërisë u bënë propozime që disa dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare t'i u akordohet titulli i lartë "Hero i Popullit". Gjë e cila ndodhte zakonisht në përvjetorët jubilarë të çlirimit të Shqipërisë e ndonjë festë tjetër, kryesisht ajo e 10 Korrikut, ditës së krijimit të "Ushtrisë Popullore". Në këtë kuadër, atë periudhë kohe, pra në vitet 1973-'74 gjë e cila koincidente edhe me rastin e përrimit të Varrezave të Dëshmorëve në Tiranë, u dha porosi që nga rrethe të ndryshme të vendit, do përzgjidheshin edhe disa dëshmorë, eshtrat e të cilëve do sillleshin në varrezat e reja në Tiranë, ku sapo kishte përfunduar edhe monumenti "Nënë Shqipëri". Nisur nga këto, në atë kohë u vunë në lëvizje Komitetet e Partisë së rretheve në bashkëpunim me organizatat e veteranëve për të bërë përzgjedhjen e tyre dëshmorëve që do shpallehin "Heronj të Popullit" dhe atyre që do u transferoheshin eshtrat për në Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë. Gjë e cila nuk ishte fort e lehtë dhe filloi të krijonte problemet e çarjet e para ndërmjet klaneve të ndryshme jo vetëm në organizatat e veteranëve të Luftës, por edhe në drejtuesit e Komiteteve të Partisë së rretheve që merrnin edhe vendimet përfundimtare për përzgjedhjen e dëshmorëve. Një gjë e tillë rezultoi të ketë ndodhur në rrethin e Peshkopisë në



Tefta Cami

vitet 1973-'74, ku "molla e sherrit" u bë dëshmori Ahmet Cami, babai i Tefta Cami, një vajzë e re dibrane mjaft e emancipuar, e cila falë vullnetit, kërkesave ndaj vetes dhe punës së saj të palodhur, kishte ngjitur shkallët e karrierës: nga mësuese, redaktore në gazetën lokale "Oshëtima e maleve" kryetare e organizatës së gruas, sekretare e Komitetit të Partisë së Rrethit për propagandën dhe njëkohësisht kandidat e Komitetit të Qendror të PPSH-së. Natyrshëm që në të gjitha këto poste dhe funksione jo pak të larta, atë e kishte ndihmuar mjaft edhe të qenit një "vajzë dëshmorë", gjë e cila siç dihet tashmë në atë kohë ishte një favor jashtëzakonisht i madh për të gjithë ata që synonin të bënin karrierë partiake apo shtetërore. Pikërisht në këtë kohë që "shoqja Tefta Cami" ishte në funksionin e sekretares për propagandën, në gazetën "Oshëtima e Maleve", të cilën ajo e kishte nën vartësi direkte, u botua një shkrim për babain e saj, dëshmorin Ahmet Cami, ish-komandant i çetës së

Gollobordës që thuhej se kishte mbetur i plagosur në rrethana të paqarta diku nga tetori i vitit 1943 dhe kishte humbur jetën në spitalin e Tiranës ku e kishin sjellë për mjekim, më 23 tetor 1943. Ahmet Cami, pinjoll i një familje me emër të madh nga fshati Viçisht i Gollobordës, në periudhën e Monarkisë së Zogut kishte shërbyer si ushtarak në disa rrethe të vendit dhe në periudhën e pushtimit nazifashist të vendit, kishte krijuar dhe komandonte çetën partizane të Gollobordës, ku thuhet se nuk kishte asnjë komunist, duke filluar nga vetë Ahmeti që ishte me bindje nacionaliste. Krahas kësaj çete, po në atë kohë në rrethin e Dibrës ishte, gjithashtu, edhe çeta partizane, apo siç u njoh më pas; "Batalioni partizan i Dibrës" i komanduar nga Haxhi Lleshi, një nga figurat me popullaritet të madh asokohe jo vetëm në trevën e Dibrës, por edhe në të gjithë veriun e Shqipërisë. Ndryshimi në mes çetës apo batalionit partizan të komanduar nga Haxhi Lleshi dhe çetës së Gollobordës që ko-

mandohej nga Ahmet Cami, ishte se kjo e dyta kishte shumë më pak efektiv në numër dhe, siç thamë më lart, asnjë komunist. Ndërsa në përbërje të batalionit partizan të Haxhi Lleshit, kishte mjaft komunistë dhe emra të njohur që nga ajo kohë dhe më pas si: Sul Baholli, Rrahman Hanku, Rexhep Doda, Ahmet Jegeni, Ymer Lleshi, Xhavit Hatipi, Hilmi Çausholli, etj., disa prej të cilëve pas mbarimit

të luftës dhe më tej ishin në poste ministrash apo anëtarë të Komitetit Qendror të PPSH-së. Disa nga këta emra të sipërcituar, kryesisht veteran të Luftës Antifashiste, nuk e pritën mirë artikullin e gazetës "Oshëtima e maleve" për dëshmorin Ahmet Cami, madje reagon ashpër menjëherë duke i dërguar një letër Sekretarit të Parë të Komitetit të Partisë së Rrethit Peshkopi, Hekuran Isait, i cili sapo kishte shkuar në atë detyrë duke zëvendësuar Sul Bahollin, që kishte ardhur me ngritje në Tiranë si ministër pa portofol. Në letrën e tyre ata veteranë me origjinë nga Dibra i bënin me dije "shokut Hekuran Isai" se shkrimi për dëshmorin Ahmet Cami kishte shumë pasaktësi. Thënë më qartë, ata e shikonin atë shkrim në kuadrin e një propagandë që po i bëhej figurës së dëshmorit Ahmet Cami nga vetë e bija, Tefta, me anë të njerzëve që ajo kishte në vartësi, për "të përgatitur terrenin" që ai të shpallej "Hero i Popullit". Gjë e cila nuk pranohej kurrsesi prej tyre, pasi në një farë mënyre jo vetëm ulte figurën dhe "meritat e luftës" të shokut Haxhi Lleshi", por sipas tyre, "çfarë heroizmi kishte bërë Ahmet Cami, që të shpallej 'Hero i



Popullit"?! Pra, një luftë klanesh "për merita lufte" që asokohe përktheheshin në një "luftë për pushtet dhe karrierë". Në këtë kontekst, letra veteranëve dibranë që asokohe jetonin e punonin të gjithë në Tiranë dhe që gjatë Luftës kishin qenë bashkëluftëtarë të ngushtë të Haxhi Lleshit, duket se ka acaruar shumë Tefta Camin, saqë ajo i është drejtuar me një letër ankese, direkt Enver Hoxhës, duke akuzuar hapur vetë Haxhi Lleshin që fshihej pas asaj letre. Sipas dëshmitëve të disa personazheve të njohur me origjinë nga Dibra, mendohet se Tefta Cami nuk do guxonte ta bënte dot atë letër ku ankohej për Haxhi Lleshin, pa pasur një mbështetje apo përkrahje nga një prej udhëheqësve kryesorë të Partisë që vinin direkt pas Enver Hoxhës, siç ishte Hysni Kajo, të cilit, gjithashtu, ajo i kishte dërguar një ko-







pje të letrës që po i dërgonte Enver Hoxhës. Po ashtu ky version bëhet më i besueshëm, po të shikojmë edhe letrën në fjalë, ku Tefta Cami i ka shkruar edhe Manush Myftiu, sekretarrit të Parë të Komitetit të Partisë së Tiranës, duke i kërkuar që të analizojë puna e autorëve të letrës, nëpër organizatat e partisë, ku ata militonin në qytetin e Tiranës. Pra, thënë më qartë, Tefta Cami duket që "e kishte kopsitur" mirë punën para se ta dërgonte atë letrë në adresë të Enver Hoxhës, pasi "shoku Haxhi Lleshi" në atë kohë kishte besimin e plotë të Enverit dhe të ngrije krye kundër tij, dukej një herezi dhe guxim më se i tepruar. Gjithsesi ky është një deduksion logjik dhe mbetet për t'u parë, por ajo që është fakt, është se Enveri nuk ka vënë asnjë shënim mbi letrën e Tefta Camit, veçse ka shkruar "për shokun Hysni", duke ia deleguar atij problemin në fjalë. Gjithashtu, nuk dihet me saktësi se si dhe çfarë ka bërë Hysni Kapo për zgjidhjen e atij problemi që ia kishte deleguar Enver Hoxha, por po të shikojmë se si janë zhvilluar ngjarjet më pas, duket se është gjetur një "rrugë e mesme", e cila do të qetësonte edhe vetererët e nderuar dibranë dhe, gjithashtu, shokun Haxhi Lleshi, por deri diku edhe vetë "shoqen Tefta Cami". Kështu, ndërsa dëshmorit Ahmet Cami nuk u miratua për "Hero i Popullit", (propozim i cili thuhet se ishte bërë disa herë nga edhe në fundin e viteve '60-të), shoqja Tefta Cami, nga sekretare për pro-

pagandën në Komitetin e Partisë së Tiranës, fillimisht si sekretare në një prej rajoneve të qytetit ku qëndroi shumë pak, për t'u emëruar më pas në postin e ministres së Arsim-Kulturës dhe, gjithashtu, si anëtare e Komitetit Qendror të PPSH-së?! Detyrë që e ushtroi për vite me radhë, krahas asaj të deputetes së Kuvendit Popullor, ku një mandat para saj, kishte qenë edhe i vëllai, Moisi Cami. Ngritja në karrierë e Tefta Camit, thuhet se nuk mund të bëhej pa miratimin e Hysni Kapos, sekretarrit të Komitetit Qendror që mbulonte edhe sektorin e kuadrit dhe që në atë kohë i dha shumë përparësi "gjaku të ri" në Parti dhe disa "shoqeve me perspektive". Si rezultat i kësaj politike kuadri, asokohe në Byronë Politikë, në qeveri, e Kuvendin Popullor, iu hap rruga edhe disa "shoqeve me nga rrethet" si Lenka Çukos, Themie Thomait e Vitori Çurrit, të cilat i ushtruan funksionet e tyre për vite me radhë. Kështu, ndër- saka karriera e "shoqes Tefta Cami" vazhdoi në ngjitje, ajo e "kundërshtarit" të saj, Haxhi Lleshi, filloi të binde dhe ai të bëhej gjithnjë dhe më i panevojshëm për Enver Hoxhën?! Përplasja e "shokut Haxhi" me Enverin, ndodhi pikërisht kur ai (Haxhiu) po kalonte disa probleme të rënda familjare (të cilat janë bërë të njohura publikisht pas viteve '90-të edhe me dokumente arki- vore), gjë e cila e detyroi atë aty nga viti 1977, që të divorcohej nga bashkëshortja, (Haxhire Jegeni), gjithashtu, me origjinë dibrane dhe bijë e

## LETRA E TEFTA CAMIT PER ENVER HOXHEN DHE HYSNI KAPON

### I DASHUR SHOKU ENVER

Dua t'Ju informoj për një çështje, që mendoj se ka rëndësi. Sekretarrit të parë të Komitetit të Partisë së rrethit, shokut Hekuran Isaj, (për dijen) dhe kryeredaktorit të gazetës "Oshëtima e maleve", shokut Velo Cfaraku, i ka ardhur një letër nga shokët Qazim Prishtina, Rexhep Doda, Ahmet Jegeni, Ymer Lleshi, Xhavit Hatipi dhe Hilmi Çaushtollli. Këta janë disa veteranë që punojnë dhe jetojnë në Tiranë.

Letra citohet se është personale dhe sekrete. Në të shkruhet për një skicë letrare që ka shkruar gazeta lokale për babanë tim, në 23 tetor me rastin e përvjetorit të rënies. Të tilla shkrime janë bërë edhe për dëshmorë të tjerë që kanë luftuar në rrethin e Dibres.

Në letrë, veteranët bëjnë këto vërejtje;

1. Në skicën letrare mohohet roli i Partisë dhe i shokut Enver;
2. Nuk evidentohet roli i shtabit të batalionit, i çetave të tjera dhe partizanëve të tjerë që janë vrarë atë ditë.
3. Skica ka paskatësira dhe nuk përputhet me realitetin.
4. Vargjet që citohen sipër shkrimit, nuk i takojnë dëshmorit, Ahmet Cami. (Në fakt, vargjet janë zgjedhur si okelio, për rubrikën e dëshmorëve).
5. Bëjnë biografinë e babait tim, duke e motivuar se bëhet për interesin e Partisë. (Faktet historike mendoj se duhen diskutuar; pasi nuk jam aspak dakord me ta).

Për qëllimet dhe metodat që kanë përdorur këta shokë, i jam drejtuar Sekretarit të Parë të Komitetit të Partisë së Tiranës, shokut Manush Myftiu, me qëllim që ata t'i shpjegojnë nëpër organizatat e tyre të Partisë, brenda normave të Partisë. Të njëjtën kopje të letrës, për njoftim ia kam dërguar edhe Sekretarit të Komitetit Qendror, shokut Hysni Kapo.

Vendosa t'Ju shkruaj Ju, sepse më këtë çështje implikohej edhe shoku Haxhi Lleshi.

Po gjatë këtyre ditëve, shoku Haxhi Lleshi i bën të njëjtat vërejtje për shkrimin në shtëpinë e tij Sekretarit të Komitetit Ekzekutiv të rrethit, shokut Haxhi Rama.

Jam e shqetësuar; shoku Enver, qoftë për veprimin e veteranëve, letërskruesëve, të cilët e dërgonin letrën personale dhe sekrete, për të mos marrë dënim unë, qoftë dhe për trajtimin të këtij problemi nga shoku Haxhi Lleshi që nuk komunikoi drejt për drejt me Komitetin e Partisë dhe me mua, kur u takova me të në mbledhjen e Kuvendit Popullor.

Nuk do t'Ju shqetësoja shoku Enver, por jam bindur tashmë se shoku Haxhi Lleshi kërkon të krijoj opinionione kundër meje, pas kraheve, ashtu siç veproi para një viti.


Më falni për shqetësimin. Të na rroni sa malet shoku Enver.

Do jem përjetë ushtar e Partisë

27.XI.1974 Me respekt e dashuri Tefta Cami

një prej familjeve më në zë të asaj treve, fisi Jegeni. Kjo gjë, pra divorci i "shokut Haxhi" me bashkëshorten nuk mund të kalonte aq lehtë, pasi ai ishte një ndër tre figurat kryesore të regjimit komunist, dhe ai shkoi vetë tek Enveri për të dhënë shpjegime lidhur me atë veprim që kishte ndërmarrë. Nga disa burime tepër të besueshme, thuhet se Haxhiu shkoi në një orë të vonë të natës tek Vila 31 e Enverit, gjë e cila nuk hapej kurrë për asnjë njeri, kushdo qoftë ai, por Enveri duke kujtuar se do të ishte ndonjë problem Partie me mjaft rëndësi, urdhëroi që "shoku Haxhi" të hynte brenda. Pas fjalëve të rastit, Haxhiu i tha Enverit se; kishte shkuar tek ai në atë orë të vonë për t'i treguar

për një problem me mjaft rëndësi që ai kishte ndërmarrë, atë të divorcit me bashkëshorten. Ajo gjë e habiti fillimisht së tepërmi Enverin, i cili i tha se nuk kishte vepruar mirë, sidomos në atë moshë që kishte ai (Haxhiu), dhe i kërkoi arsyen se përse e kishte ndërmarrë atë veprim? Haxhiu i tregoi Enverit se; pa pëlqimin e tij, bashkëshortja, Haxhireja, kishte shkuar dhe takuar në Tiranë kushërinjët e vet të



tuar se ai ja kishte bërë të qartë asaj, se: "Të gjithë ata që vinë pi Jugosllavje dhe pi Dibre t'ë Madhe në Shqipëri, janë të gjithë agjentë titista dhe revizionista". Kur Haxhiu ia tha këto fjalë, Enveri e pyeti: "Mirë more shoku Haxhi, po gruaja ç'a të tha kur ti i the kështu"? Haxhiu i përgjigj: "Ajo më tha se; po ata që i erdhën shoqes Nexhmiye para një muaji nga Dibra e Madhe dhe Jugosllavija, ç'a ishin, agjentë"? Ndërkaq pas këtyre fjalëve, Enveri shtangou për disa minuta dhe pasi ndezi cigaren tjetër, ia ktheu Haxhiut, duke i thënë: "Shoku Haxhi, të gjithë në të tjerët gjatë punës, por dhe luftës tonë kemi bërë edhe gabime, por ti shoku Haxhi si në Luftë dhe tani gjatë viteve të pushtetit tonë popullor, të cilin e fituam me shumë gjak dhe sakrifica dhe ku ti ke pasur një rol kryesor, nuk ke bërë kurrë gabime. Jo vetëm kaq, por ke mbetur gjithnjë një ushtar dhe kuadër besnik i Partisë dhe i popullit dhe kurrë nuk e ke shpërdoruar besimin që të ka dhënë Partija". Pas kësaj bisede në atë orë të vonë të natës, "shoku Haxhi" doli nga vila e "komandantit" mjaft i qetësuar dhe në ditët që pasuan, jo vetëm që e divorcoi edhe zyrtarisht bashkëshorten, por edhe e internoi në një fshat të Elbasanit, ku atë e shoqëroi njëri nga djemtë. Ndoshta nga naiviteti apo edhe "besnikërinë ndaj Partisë" që tregoi Haxhi Lleshi në atë bisedë me Enver Hoxhën, nuk e kishte menduar kurrë se kishte "nënshkruar" edhe fundin e karrierës së tij politike dhe, gjithashtu, ndarjen përfundimtare nga Enveri. Dhe kjo gjë ndodhi pak vjet më vonë, kur Enveri e shkarkoi "shokun Haxhi" nga detyra e Kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të cilën ai e kishte mbajtur që nga fillimi i viteve '50-të, duke zëvendësuar Omer Nishanin. Madje Enveri nuk u mjaftua vetëm me shkarkimin e Haxhiut nga funksioni i Kryetarit të Presidiumit, por ai u mundua ta diskreditonte atë si figurë, gjëra të cilat tashmë janë të njohura edhe nga dokumente arkivore të publikura në shtyp vitet e fundit, ku në ditarinë e tij në mes të tjerash, Enveri ka shkruar: "Mbrëmë thirra Haxhinë, të cilin tani në pleqëri i ka shkruar mëndja dhe....". Të gjitha këto tashmë janë të njohura, ndërsa dokumenti në fjalë me letrën e Tefta Camit, publikohet i plotë dhe ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare".

## LIBRI

Promovimi/ Merr pjesë edhe Presidenti Ilir Meta dhe zv.kryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj

# "Kalvari diplomatik i Kosovës", diplomati Shaban Murati promovon librin në Tiranë

*Autori: Rreziqet ndaj çështjes kombëtare nuk kanë përfunduar*

Është përfunduar para ditën e djeshme në mjediset e hotelit "Tirana International" libri me titull "Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës" i autorit Shaban Murati. Në këtë përfundim ishin bashkuar personalitete me rëndësi në jetën e vendit, duke filluar që nga qytetari numër një i shtetit, Presidenti i Republikës z. Meta, ambasadorët e shteteve tona në kryeqendrat Prishtinë e Tiranë, ish-ministra, deputetë, studiues, njerëz të mendimit dhe qytetarë të angazhuar në sfera të ndryshme të jetës. Në këtë ceremoni fjalën e çeljes e mbajti edhe drejtuesi i Fondacionit "Alsar", Mehdi Gurra. Ky libër ishte pikërisht botim i këtij fondacioni, që nuk ishte e para herë që e mbështeste daljen në dritën e botimit të studimeve të ambasadorit Murati.

Më tej fjalën e morën prof. dr. Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës; Maxhun Peka si një diplomat në karrierë.

Prof. dr. Ylber Sela nga Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare me qendër në Shkup si dhe analisti Aleksandër Çipa nga Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë. Në recencat e tyre të gjithë pohuan vlerën e këtij studimi dhe dobishmërinë e tij në klasën politike dhe diplomatike shqiptare.

Në fjalën e tij, prof. dr. Sela, si drejtues i Institutit për Studime Politike dhe Ndërkombëtare përmendi kontributin e rëndësishëm të ambasadorit Murati gjat kohës kur shërbente në misionin diplomatik në Maqedoni, duke u ndalur sidomos në kontributin e tij në themelimin e Universitetit të Tetovës. Mes duartrokitjesh, ai tha: "Dy vjet më parë, instituti ynë organizoi përfundim në Shkup të një tjetër botimi të ambasadorit Murati", duke u ndalur në disa prej pikave më të rëndësishme të kësaj përmbledhjeje publicistike prej 64 artikujsh. Ky libër që erdhi si një buqetë mendimesh në 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës përmbledh 20 vitet në publicistikë të autorit.

"Z. Murati i qaset interpretimit diplomatik, politik



Autori i librit, Shaban Murati



Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës gjat promovimit të librit "Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës"

**SHABAN MURATI**  
"Unë si diplomat edhe analist i vjetër dua që të tërheq vëmendjen se rreziqet për çështje kombëtare shqiptare nuk kanë mbaruar, të dashur vëllezër dhe motra nëse në shekullin XX, sidomos në fillim jemi ankuar për diplomacinë e shteteve evropiane, unë përpiqem që të zgjoj alarme për diplomacinë e shteteve shqiptare", u shpreh autori.

mbëtare. Sipas z. Sela, nga përmbajta dhe metodologjia e ndërtimit të artikujve të këtij libri del se autori shfaqet si njeri me diapazon të gjerë intelektual dhe njohës shumë i mirë i rreth-

nave diplomatike evropiane dhe botërore. Me anë të kryqëzimit të informatave që kanë të bëjnë me zhvillimet aktuale politike dhe diplomatike me shembuj të ngjashëm nga e kaluara e afërt


dhe e largët historike, ky diplomat jo vetëm që nxjerr gjykime të qarta në lidhje me proceset me të cilat përballen shqiptarët gjat këtyre dy dekadave të kaluara, por njëherësh ai ndërton edhe pikëpamje tejet të avancuara mbi të drejtën historike kombëtare në krijimin e shtetit të Kosovës. Politika e jashtme me të gjitha elementet që intrigojnë paraqiten në këtë libër përmes formulave të qarta diplomatike". Siç z. Sela pohoi në fjalën e tij, botimi i çdo artikulli lidhet me momentin e duhur kohor të veprimeve apo projekteve të caktuara kombëtare dhe sidomos, ndërkombëtare. Me qëndrimet e tij të ashpra kritike në libër shprehen edhe qëndrimet korrigjuese të politikave shtetërore shqiptare, me theks të veçantë të asaj kosovare.

E ardhmja evropiane e Kosovës dhe angazhimi i shtetit në strukturat euroatlantike, ruajtja e pavarësisë shtetërore dhe tërësisë territoriale të saj si dhe njohja e shtetit të Kosovës nga Serbia si prioriteti numër një ishin disa nga elementet që z. Sela vlerësoi në fjalën e tij mbi librin e ambasadorit Murati.

Sipas tij, boshti tematik i numrit më të madh të artikujve mbështet në procesin e shkëputjes së Kos-

ovës nga Serbia, procesin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë, procesin e bisedimeve të Kosovës me Serbinë dhe sjellja e qëndrimit i shqiptareve ndaj miqve tradicionalë dhe aleatëve strategjikë, si dhe ndaj institucioneve dhe shteteve tjera të cilat, - theksoi ai - luajnë një rol të rëndësishëm në planin të politikave gjeo-strategjike ndërkombëtare.

"Këtë libër e botova më shumë për të rritur sensibilitetet mbi çështje shumë të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, siç është çështja kombëtare. Natyrisht, çështja kombëtare shqiptare nuk kanë mbaruar të dashur vëllezër dhe motra nëse në shekullin XX, sidomos në fillim jemi ankuar për diplomacinë e shteteve evropiane, unë përpiqem që të zgjoj alarme për diplomacinë e shteteve shqiptare. Në kuptimin që shoqëria edhe institucionet të jenë vigjilentë për ta forcuar shtetin edhe në Tiranë, edhe në Prishtinë që të neutralizohet çdo lloj përpjekjeje që të sabotuar çështjen tonë kombëtare", tha autori.



## SHKODER 1913



# SHKODËR 1913

## Dalin pamjet e rralla, shqiptarë të uritur, malazezë që festojnë e kufoma pa varr

Fatmira Nikolli

**B**urra e gra me thasë në shpinë, të veshur keq, me rroba popullore, siç e donte koha, të rraskapitur, me fëmijë në duar, me kafshët me vete, duke ecur, mbase duke u shpërngulur nëpër një rrugë plot pluhur, ta pashtuar. Fëmijë të vegjël rreken të ndjekin hapat e të rriturve me torba në duar në të njëjtën rrugë ku dhimbja e frika i shtojnë të ikën nga sytë këmbët.

Një batalion ushtarësh ecën pothuaj në parakalim, të tjerë 'kanë veshur' dy anët e rrugës, duke u hapur udhë kalimtarëve. Mes tyre, kalojnë edhe grupe ushtarësh që duhet të jenë banda e ushtrisë. Pas tyre flamurtari me flamurin që valëvitet, ushtarë me armë e kuaj të bardhë.

Copëza filmike shënon në gjuhën frënge: "Trashëgimtari i kurorës Danilo dhe princi Petar i Malit të Zi, zbrasin nga këshjtjella pasi iu dorëzua shpata e Esad Pashës.

Është viti 1913 dhe pashai ka humbur luftën. Për shkak të urisë, ushtarët e tij e kanë të pamundur të vijojnë mbrojtjen dhe ai e dorëzon Shkodrën. Kjo është damka më shumë se 1 shekullor ndaj tij për ç'arsye ju vu shpesh nofka e tradhtarit dhe u 'shpall' armik.

Po në gjuhën frënge shënohet: DY FYTYRAT E FITORES: në një anë një flamur që valëvitet mes një grupi fitimtarësh të hareshëm dhe nga ana tjetër, një grupë varri ku kufoma që nuk njihen më po kalben krejtësisht nën diellin e pamëshirshëm.

Një filmim pa zë, bardh e zi, u gjet në Kinotekën e Malit të Zi në vitin 2008 dhe pas procesit të restaurimit në digjital dhe 35 mm në laboratorin "Hungarian Film Lab", do të ruhet në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit si filmimi më i hershëm i fondit filmik të AQSHF-së. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në bashkëpunim



*Imazhet e dorëzimit të qytetit nga Esad Pasha, flamuj që valëvitet e skamje e pafund*

me 'EYE Film Institute', Kinotekën e Malit të Zi dhe mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, mbajtën të mërkurën në orën 19:00 një koncert me filmime arkivale të xhiruara në Ballkan në fillim-shekullin e njëzetë.

Me muzikë origjinale të kompozuar nga Adorel Haxhijaj, premiera e filmimit të restauruar "Dorëzimi i Shkodrës" (1913) u shoqërua me performancë 'live' nga Adorel Haxhijaj në cello dhe Astrit Stafai në oud. Gjashtë kronika të shkurtra bardhë e zi dhe të pikturuara me dorë janë pjesë të programit "Në kërkim të Perandorisë Otomane" dhe u përgjodhën në bashkëpunim me kuratoren e filmimit pa zë të Institutit të 'Filmit EYE' të Holandës, Elif Rongen-Kaynakci. Peizazhet unike vizuale të racionit të Ballkanit, u ndoqën nga premiera e restaurimit të filmimit francez Pathé të vitit 1913, titulluar "Dorëzimi i Shkodrës", me pamje të qytetit verior pas përfundimit të rrethimit gjashtë mujor të tij. Një varkë me vela mbase mbi

Bunë, gra të veshura me rroba popullore, çobaneshë e një e moshuar me furkë. Pak çaste më vonë, Shkodra bardh e zi, banorë që ecin për krahu xhamisë, kur në fund të kuadrut duket stoike Kisha e Madhe. Në fund, një malësor mbi kalë, me pushkën në dorë e sheh



kamerën drejt e në objektiv-qenë imazhe të tjera mes filmimit.

Dorëzimi i Shkodrës është një prej ngjarjeve historike më të debatueshme në vendin tonë. Botime e studime të ndryshme historike i heqin sa edhe i vënë mbi supë faje, Esad Pashës, që pasi e mbrojti një kohë të gjatë e dorëzoi qytetin mes skamjes e urisë. Pamjet e sjella së fundmi që u shfaqen këtë të mërkurë, në një farë mënyre pohuan të dhënat e librit "Esad pa-

shë Toptani: Njeriu, lufta dhe push-teti" (UET PRESS) të Ilir Ikonomit i cili përmes dokumenteve shënon se se qe uria ajo që e bëri Esad Pashanë të dorëzohej.

"Nëse ke vetëm kaq për të thënë, më mirë kurseji fjalët! Është qesharake të ofrosh dyqind a treqind lopë për njëzet mijë njerëz që ushqehen keq prej një muaji. Është cinike të bësh këtë ofertë tani që i kam helmuar ushtarët e mi me kërmata e kuajve. Esadi tha se askush nuk mund ta mësonte se si ta kryente detyrën e tij. - Kur them që dorëzimi është i domosdoshëm, - vazhdoi ai, - kjo do të thotë se kam pritur deri në çastin e fundit, përtej të cilit nuk mund të vazhdohej më pa cenuar dinjtetin dhe nderin tonë. Shihni si janë katandisur ushtarët. Nuk na ka mbetur asnjë thes miell. Racioni për sonte ishte një gjysmë peksimadhe dhe një grusht stafidhe. Kam dymijë të sëmure dhe të plagosur nëpër spitale. Municionet e topave thuajse janë shteruar dhe një sulmi malazez nuk i përgjigjet dot më gjatë se 15 minuta me artileri. Nuk ju ka lezet të bëni patriotizëm në orën e fundit", - qe shprehur Esad Pasha.

# Arsimi dhe formimi shkencor përballë sfidave

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

... shoqërore po rritet? Çfarë na ofrojnë për këtë studiuesit dhe projektet kërkimore nga bota?

## 1. NDRYSHIMI I PARADIGMËS

I shquari Tomas Kuhn-it (Kuhn 1970) e ka përshkruar progresin shkencor jo si akumulimin gradual të dijeve, por si seri revolucionesh - ose "ndërrim paradigmesh" (koncepte ose modele mendore këto që mundësojnë dhe certifikojnë kontributin në një fushë). Ka periudha të gjata kur ajo, që ai e quan "shkencë normale" apo "zgjidhje e enigmës", zhvillohet si veprimtari që strukturohet sipas konceptimit të fushës dhe problemeve të saj. Shfaqen anomalitë dhe shkencëtarët që zgjidhin enigmën punojnë për ta shpjeguar atë nga brenda paradigmes ekzistuese. Megjithatë, dhe përfundimisht, anomalitë shpesh nënë krizë. Ka debate ose konflikte, që mund të jenë edhe të hidhura, çka kërkon ndryshim. Nëse anomalitë nuk arrijnë të zgjidhen, fusha i nënshtrohet ndryshimit të paradigmes, si largim radikal nga mënyra e vjetër e të menduarit të gjërave. Ajo zëvendësohet nga e reja, që nuk përputhet me të mëparshmen. Fusha shkon në drejtim të ri, me energji dhe/ose me mjete të reja konceptuese. Fillon periudha e "shkencës normale", në kornizat e paradigmes së re.

## 2. FORMIMI SHKENCOR NË NGËRÇ

Tipari përcaktues i formimit shkencor të rinisë, siç është zhvilluar ai gjatë shekullit të shkuar e deri tani, ka qenë përpjekja për "zgjidhjen e enigmës". E lidhur kjo me dy pyetje kyçe: si të mësohet sa më mirë shkenca dhe/ose si të angazhohet sa më shumë subjektet në studim e shkencës? Janë shfaqur anomalitë dhe ka pasur thirrje të shumta për ndryshim. Me temë qendrore pabarazimet/konfliktin ndërmjet kurrikulës në shkolla dhe nevojave e interesave të rinisë. Projekt pas projekti kërkimor është hulumtuar tema dhe janë propozuar shumë zgjidhje. Megjithatë, dhe pavarësisht kësaj, vazhdon të tkurret pjesëmarrja e të rinjve në studimin e shkencës (kur kjo nuk është e detyrueshme). Sikundër nuk është përmirësuar niveli i interesit/angazhimit në shkencë dhe kuptimi i saj nga të rinjtë (OECD 2006, 2009, 2012, Osborne & al. 2009, Tytler 2007). Pjesërisht, por jo tërësisht, meqë zotërimi i shkencës mendohet si çelësi i përparimit ekonomik, çdo disa vjet, identifikohet një "krizë" në formimin shkencor (Aubusson 2013, Toscano 2013). Janë ofruar



raporte dhe hulumtime, rekomandohen modele novatore mësimore dhe sillen kurrikula të reja (Gluckman 2011, Bull, Gilbert & al. 2010). Disa nga këto kërkime gjejnë rrugën në retorikën e politikës dhe në mjediset e nxënies, por nuk ka ndryshime të paradigmes dhe të praktikës pedagogjike. Gjërë vijojnë si përherë. Gjatë shekullit të fundit, apo diçka më shumë, me një ritmikë përsëritjeje prej afro 20 vitesh, në debatin për formimin shkencor ka kulmuar njëri prej pozicioneve konkurruese ontologjike. I pari ka theksuar kërkesat disiplinore të shkencës. Sipas tij,

formimi është çështje teknike - të udhëzohet apo të ndihmohet sa më mirë të rinjtë, që të përfshihen në disiplinë. Pozicioni i dytë ka theksuar konsideratat pedagogjike - formimi më i mirë universitar i mësuesve; nxëniet në bashkëpunim, e-learning, nxitja e mendimit kritik etj.

## 3. E ARDHMJEA E ARSIMIT

Në dy dekadat e fundit janë ndërmarrë hulumtime dhe janë ofruar komente mbi të ardhmen e arsimit. Referencat tek arsimi i "fokusuar tek e ardhmja", të "nxëniesit e shekullit 21" apo të "fëmijët e erës digjitale" e kështu

me radhë, tani janë një rutinë, veçanërisht në kontekstet e politikës. Kjo letërsi argumenton se shkollat e sotme nuk janë në gjendje t'i përgatisin si duhet të rinjtë për botën gjithnjë e më të ndërlikuar, të paqartë dhe në ndryshim të shpejtë të së ardhmes se, tani nevoja për ndryshim është urgjente (Khan (2012), Leadbeater (2011), Miller & al. (2008), Miller & Bentley (2003), Murgatroyd (2011), Prensky (2001), Robinson (2011), Tuomi & Miller (2011), Wagner (2012)).

Një histori me dy pjesë e paraqet këtë letërsi. Pjesa e parë e saj shpalos disa prej "mega tendencave" që udhëheqin "ndryshimin e paradigmes" që po ndodh në botën përtej arsimit. Kjo listë, zakonisht, përfshin, së pari, "revolucionin digjital" - rritjen eksponenciale të fuqisë informatike të rrjeteve digjitale dhe implikimet për shoqërinë, ekonominë, natyrën dhe shpërndarjen e mundësive të punësimit (Kurzweil 2005, Brynjolfsson & McAfee 2011). Tendanca e dytë shpreh globalizimin - shuarjen e kufijve ndërmjet shteteve-kombeve dhe ekonomive të tyre. E treta shtjellon format "e rrjetëzuara" të dijeve të reja, që janë dhe do të bëhen "shumë të mëdha

për t'u njohur" (Castells 2000, Weinberger 2011). E katërta ka të ngjarë të rezultojë nga ndryshimet demografike dhe ekonomike që po ndodhin p.sh., grupi i vendeve të BRICS-it (Marginson & al. 2011). Mega tendanca e pestë përfshin zhvillimet që lidhen me antropocenin (epokë e re gjeologjike kjo, që ka filluar përafërsisht me Revolucionin Industrial dhe me përdorimin e lëndëve djegëse fosile), me ndryshimet klimatike dhe me shumë "probleme të pakëndshme", me të cilët do të përballemi tani e në vijim. Këto probleme janë komplekse, të vështira, që nuk mund të zgjidhen apo të përkufizohen, duke përdorur mjetet dhe teknikat e një disipline. Për shkak të shumta dhe ndërvarësi komplekse, përpjekjet për të zgjidhur një aspekt të një problemi të pakëndshëm, shpesh zbulojnë ose krijojnë probleme të tjera.

Këto tendenca, pohojnë studiuesit të ndryshëm, ka të ngjarë të prodhojnë fundin e punës siç e njohim atë aktualisht. Pjesa më e madhe e punëve prodhuese, si dhe të gjitha punët profesionale, do të zëvendësohen me teknologjitë inteligjente, çka do të ndikojë pjesë të mëdha të veprimtarisë shkencore. Shuarja e kufijve të shtetit kombëtar p.sh., mund të kufizojë aftësinë për të mbledhur taksa, çka do të kufizojë kapacitetin për të ofruar shërbime publike, investime në infrastrukturë e kështu me radhë. Pabarazitë sociale do të rriten. Pastaj, ekzistojnë efektet fizike të ndryshimeve klimatike. Së bashku, këto tendenca përfaqësojnë sfida të fuqishme për rendin aktual dhe për "mënyrat e njohura" se si i bëjmë gjërë. Në këtë kontekst ndodhet dhe arsimi (Gilbert 2015).

Në pjesën e dytë të historisë që po sjellim në vëmendjen tuaj, shkollat portretizohen sikur kanë dështuar që t'u përgjigjen këtyre tendencave. Ato cilësohen si inerte, të papërditësuara, të vjetruara "që nuk i përmbushin qëllimet". Pjesë e një epoke të shkuar, shkollat mbështeten dhe janë të përfshira në "dije të vjetruara", në "sisteme të vjetra" dhe "teknologji të kapërcyera". Ne kemi nevojë, vijon argumenti, që të "revolucionojmë" arsimin, ta rindërtojmë atë nga themelet, që të plotësojmë më mirë nevojat e "kohëve të reja".

Ndonëse e përhapur dhe e njohur, kjo histori nuk ia ka dalë të prodhojë revolucionin në mendimin për arsimin. Shkollat vazhdojnë të organizohen me të njëjtat dije, të njëjta sisteme dhe, në masë të mëdha, të njëjtat teknologji (në kuptimin më të gjërë të këtij termi). Në retorikën e politikës për të →

Opinioni **i** Ditës

# Të ndihesh askushi

Dr. Av. Sinan Tafaj

(vijon nga faqja 1)

... të drejtën ata që flisnin në emër të tyre. Ishte pothuajse si një e drejtë hyjnore e trashëguar. Qytetarët e asaj kohe në mendjen e tyre ishin lindur thjesht për t'u bindur, ku ëndrrat dhe dëshirat e tyre ishin të kornizuara, ku respekti për veten ishte minimalist, ku aftësia për të vendosur ishte brenda derës së shtëpisë. Ata ishin plotësisht të qartë se pjesëmarrja në votim ishte formale. Kur isha student në Fakultetin Juridik, me naivitetin tim rinor, njërit nga profesorët më të nderuar i parashitja këtë pyetje: Të votuarit është veprim apo mendim? Kur më tha se pse e pyesja unë argumentova: "Shteti i diktaturës së proletariatit nën çdo veprim që synon ta përmbyti atë". Po në rast se qytetarët shqiptarë votojnë kundër diktaturës a është ky një veprim që e rrezon atë? Nëse po pse nuk e dënon?

## PËRJASHTIMI SHOQËROR

Në diktaturë të gjithë e dinim se votimi ishte një proces formal pa kurrfarë vlere pasi qartësisht



nuk kishte garë. Sot pjesëmarrja në votim demotivohet nga paragjykimet se gara është e fituar, se gara nuk është reale, se vota e individit nuk ka kurrfarë vlere. Pjesëmarrja në votim është tashmë një proces aspak i lirë dhe përjashtues. Kufizimet lidhen jo vetëm me pamundësinë objektive

të arritjes së kutive të votimit, por dhe me faktin se një numër zgjedhësish nuk regjistrohen fare me paragjykimin se kanë probleme mendore.

Është e vërtetë se numri i atyre me probleme mendore në vendin tonë është i konsiderueshëm, por nuk është aspak e vërtetë se

të gjithë janë të paafetë për të vlerësuar votën dhe për të bërë zgjedhjen e tyre. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e PAK e ratifikuar nga Kuvendi në vitin 2012, në nenin 12-të ka krijuar një institut të ri të së drejtës që quhet vendimmarrja e mbështetur. Qëllimi i këtij instituti të së drejtës është që askujt të mos i mohohet e drejta për të vendosur vetë, por nëse ka deficienca ato t'i kompensohen nga mbështetës të garantuar që s'kanë konflikt interesi dhe nuk abuzojnë me nevojtarin nga shteti. Kështu pra mundësohet pjesëmarrja në votim edhe për ata me probleme mendore nëse respektohet neni 12-të i konventës për vendimmarrjen e mbështetur. Kryesuesit e Komisionit të Kuvendit për Reformën Zgjedhore duhet ta parashitnin për të zgjidhur këtë ngërc edhe pse palët në garë mund ta paragjykojnë si një rast për t'ia hedhur njëra-tjetrës. Respektimi i konventës dhe i Kushtetutës për lirinë e pjesëmarrjes në zgjedhje është "gur themeli" në shtetin tonë ligjor.

*\*Ekspert në Institutin e Ekspertizës së Personave me Aftësi të Kufizuara.*

← ardhmen e arsimit, mbi-zotërojnë dy "ide të mëdha". E para është performanca më e mirë e sistemit - sistemi "i orientuar drejt së ardhmes" është ai që prodhon shkallën të larta të arritjeve të shkollorëve dhe më shumë të tillë me kualifikime universitare. I dyti është digjitalizimi dhe menaxhimi më i mirë i të dhënave. Megjithatë, edhe këto ide, sikundër ofrohen nga tradicionalistët, janë më shumë përdorim mjeshtror i kuptimeve të "vjetra" të arsimit, se sa një kornizë për përgatitjen e rinjve për të jetuar, menduar dhe vepruar në botën e nesërme.

Paaftësia e dukshme e arsimit për të orientuar veten bazuar në "mendimin për të ardhmen", sikundër paaftësia e formimit shkencor për të gjetur rrugën e tij nga ngërçi ku ndodhet, ka të bëjë me gjenealogjinë e tij, me disa "ide të mëdha", që në epokën post-moderne antropocene mund të mos zbatohen më. Arsimi, ashtu si e njohim sot, u krijua në tranzicionin nga ekonomitë dhe shoqëritë bujqësore tek ekonomitë dhe shoqëritë që e orientuan veten kryesisht drejt industrializimit dhe urbanizimit. Zhvillimi i arsimit masiv vletë për rolin e tij në prodhimin e burimeve njerëzore dhe të konsumatorëve të nevojshëm në ekonomitë moderne. Kurrikula e shkollave, përfshirë edhe shkencën, u zhvilluan për të mbështetur rritjen e ekonomive/ shoqërive moderne. Megjithatë, duket po i vjen fundi modernizimit që bazohet në djegien e lëndëve fosile, periudhë kjo që disa autorë e karakterizojnë si "kapitalizëm i karbonizuar" (Newell&Patterson 2010).

## 4. ARSIMI DHE

## TË ARDHMET E NDRYSHME

Gjithë sa më sipër ka implikime përtej kontekstit ekonomik. Janë në proces analizat sociologjike dhe filozofike të implikimeve të erës antropocene për supozimet kryesore të modernizimit. Disa dijetarë po ofrojnë një paradigme të re të teorisë shoqërore "pas karbonit" për përpunimin e koncepteve moderne të shoqërisë, politikës dhe ekonomisë (Newell&Patterson 2010, Irwin 2010, Urry 2011, Elliot&Turner 2012; Klein 2014). Komentesit në disiplina të tjera flasin për zhvendosjen në "kohën postnormale" (Sardar 2010, Ravetz 2011, Therje 2012). Ky togfjalësh u përdor së pari në vitet 1990, për të përshkruar ndryshimet në shkencë (Ravetz 1993) dhe po aplikohet gjerësisht në mjaft disiplina të ndryshme. Çelësi i kuptimit të termit është dija se gjërat nuk janë më të sigurta, të thjeshta ose të qëndrueshme (nëse kanë qenë ndonjëherë). Pasiguria, kompleksiteti, kaosi dhe kontradiktat janë normalja "e re". Siç thotë Sardar: "Ne je-

tojmë në një periudhë në të cilën ortodoksitë e vjetra po vdesin, të reja ende nuk duket të lindin dhe shumë pak gjëra duket të kenë kuptim. E jona është një moshë kalimtare, një kohë pa besimin, që ne mund të kthehemi në ndonjë të kaluar që kemi njohur dhe pa besimin në ndonjë rrugë drejt një të ardhme të dëshirueshme dhe të qëndrueshme të arrihshme" (Sardar 2010).

Tani, gjithçka është komplekse, thellësisht e ngatërruar, e ndërlikuar, e paparashikueshme dhe e hapur. Çdo problem ka përmasa të shumëfishta, nuk mund të ketë përgjigje "të drejta" ose "të gabuara", mund të ketë vetëm mënyra të ndryshme për ta kuptuar problemin. Nëse, siç argumentojnë këta teoricienë, kemi kaluar në epokën postnormale pas karbonit dhe konceptet kryesore të modernitetit nuk zbatohen më, atëherë do duhet të mendojmë përsëri për kuptimin e "arsimit" dhe të "shoqërisë". Por edhe për kuptimin (dhe qëllimin) e lëndëve shkollore tradicionale, përfshirë shkencën. Shkollat, nëse do vazh-

Shuarja e kufijve të shtetit kombëtar p.sh., mund të kufizojë aftësinë për të mbledhur taksa, çka do të kufizojë kapacitetin për të ofruar shërbime publike, investime në infrastrukturë e kështu me radhë. Pabarazitë sociale do të rriten. Pastaj, ekzistojnë efektet fizike të ndryshimeve klimatike. Së bashku, këto tendenca përfaqësojnë sfida të fuqishme për rendin aktual dhe për "mënyrat e njohura" se si i bëjmë gjërat. Në këtë kontekst ndodhet dhe arsimit (Gilbert 2015).

Tiranë, më 17.10.2018

## HOROSKOPI

### DASHI

Sa i përket jetës sentimentale dhe asaj familjare, personat e lindur në këtë shenjë do të përmirësojnë jetën e dashurisë. Nga ana e ngritjes profesionale shumë të lindur në këtë shenjë do të kenë suksese të mëdha.

### DEMI

Sa i përket jetës sentimentale dhe asaj familjare, personat e lindur në këtë shenjë do të përmirësojnë jetën e dashurisë. Nga ana e ngritjes profesionale shumë të lindur në këtë shenjë do të kenë suksese të mëdha.

### BINJAKET

Në punë do të gjendeni para situatave të palakmueshme. Gjërat do të përmirësohen në pjesën e dytë të ditës. Në dashuri jvet ju sugjerojmë që lidhjet serioze t'i trajtoni me kujdes.

### GAFORJA

Mund të keni paksa vështirësi financiare, por gjërat do rregullohen. Ndërkaq, në dashuri të martuarit do të përballen me disa probleme të vogla. Të pamartuarit do të krijojnë marrëdhënie të shkelqyeshme me të tjerët.

### LUANI

Në dashuri do të ketë probleme vetëm për të martuarit. Karakteri i kësaj shenje është i këthill. Megjithatë, do i rregulloni ato ngadalë! Me financat duhet të tregoni kujdes.

### VIRGJERESHA

Në dashuri do të keni lajme të mira. Ndërkaq shëndeti parashikohet të jetë shumë i mirë. Me paratë nuk i keni punët shumë mirë, por kjo sepse jeni pak dorërlësuar.

### PESHORJA

Në dashuri çiftet do të kenë probleme në komunikim. Në punë do të jeni shumë të relaksuar, kjo edhe për shkak të disa sukseseve. Edhe shëndeti parashikohet të jetë shumë i mirë.

### AKREPI

Në përgjithësi karriera do të jetë e begatshme për këtë shenjë. Në dashuri duhet të mësoheni me jetën familjare dhe të ndërtoni një harmoni më të madhe. Një udhëtim shfaqet në sfond.

### SHIGJETARI

Duhet të jeni më të bindur në arritjen e qëllimeve tuaja. Nëse merreni me biznes, fokusohuni më shumë të shpenzimet. Shëndeti do të jetë shumë i mirë.

### BRICJAPI

Disa probleme të zakonshme në punë do ju shqetësojnë pak. Jeta profesionale do të komplikohet nga mungesa e suksesit. Mendoni pozitivisht dhe gjërat do ju ecin mbarë.

### UJORI

Parashikohet të keni sukses në dashuri. Një investim që keni bërë do ju japë shumë përfitime financiare. Sa i përket shëndetit, përipiqni të pushoni më shumë.

### PESHQIT

Disa pengesa që ju dalin në punë do të mund t'i tejkaloni me shumë maturi. Në sferën e dashurisë do të keni një përplasje me partnerin që vjen si pasojë e financave.

PORTIERI I PSG-së



Trofeu i "Topit të Artë" është padyshim një çmim që ndoshta e nderojnë të gjithë futbollistët. Si një çmim kaq shumë prestigjioz ai është edhe shumë i diskutuar dhe të gjithë figurat e futbollit japin mendimet e tyre për të. I fundi ka qenë Khanluixhi Bufon i cili e ka harruar

Bufon shkurorëzon Ronaldon: E meriton Mbape "Topin e Artë"

Mesin dhe Ronaldon. Ish-portieri i Juventusit ka thënë se Topin e Artë duhet ta fitojë shoku i tij i skuadrës te PSG, Kilian Mbape. "Mbape është një fenomen. Nëse ai vazhdon

duke treguar me të mirë, nëse ai mbetet në entuziazmin e tij dhe vazhdon të sillet normal, pastaj ai do të jetë në këto nivele për kohë të gjatë. Në Itali e krahasojmë atë me Roberto Bax-

hio, Françesko Toti, Alessandro Del Piero, por ai ka talent dhe teknik që rrallë i kam parë në karrierën tim. Për kualitetet e tij, çfarë ai ka bërë dhe si ka qenë vendimtar në Botëror ai e meriton Topin e Artë. Nuk mund ta them të kundërtën". - ka thënë Bufon.

Anësoni shijon nisjen e mirë dhe shpreson që ky të jetë viti i duhur për kryeqytetasit



Jeton Selimi

Djemtë e tmerrshëm" të Skënder Gegës! Ky është përkufizimi që mediata i kanë bërë së fundmi treshes sulmuese të Partizanit, ku Asani, Mala dhe Bardhi janë autorë të një loje shkatërruese për kundërshtarin, tekta i kanë siguruar skuadrës së tyre vendin e parë në renditje. Kup-tohet që vetëm nuk ia kanë dalë, pasi moshja e tyre e re ka nevojë pa fund për eksperiencën e Telushit, Trashit dhe kapitenit Hoxha. Nëse do të bënim një krahasim me të këndshëm, ata janë një tris asash në dorën e Gegës, por kanë nevojë pafund dhe për asin e katërt, ekipin, për t'u shndërruar në një dorë të pafundshme përballë kundërshtarit. Për Jasir Asanin, autor i një nisjeje mbresëlënëse të kampionatit, kjo nuk është aspak një rastësi, pasi po punohet shumë që të merret maksimumi nga një grup që mbase më herët pakkush e kishte imagjinuar kaq të fortë. Thënë me gjuhën e folur deri më tani, Asani e ndjen se ky është viti për të bërë "all in", por si ai, ashtu dhe shokët e ekipit dhe stafi teknik, nuk do ta hedhin kurrë kandidaturën pa ardhur dora e duhur e letrave! **Jasir, si po shkonë përgatitjet në prag të ndeshjes me Luftëtarin?** Gjithçka po shkon për mrekulli. Jemi të uritur për sukses dhe njëkohësisht me këmbë në tokë. Luftëtarit është një skuadër që na ka hapur



shumë telashe sezonin e shkuar, ndaj nuk do të ketë asnjë nënvlerësim pavarësisht se këtë vit nuk kanë të njëjtin ritëm. **Partizani komandon kampionatin i vetëm në krye. A e kishit besuar në fillim të se-**

**zonit diçka të tillë, pasi opinioni ishte vërtet skeptik me atë që ju do të bënit?** Sepse ende nuk na kishte parë në fushën e lojës. Gjithsesi të mos harrojmë se nuk kemi bërë ende asgjë. Partizani ka kryesuar dhe në të shkuarën,

# Asani: Ende s'kemi bërë asgjë, jemi të gjithë 'ushtarë' të kuq

Shkupjani për merkaton: Më intereson veç Partizani

SUPERLIGA		
JAVA E 9-të		
TE SHTUNEN		
Kastrioti - Kukësi	14:00	
Laçi - Teuta	14:00	
TE DIELEN		
Skënderbeu - Kamza	14:00	
Partizani - Luftëtarit	17:00	
TE HENEN		
Flamurtari - Tirana	18:00	
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	8	19
Skënderbeu	8	17
Laçi	8	16
Kukësi	8	13
Flamurtari	8	11
Teuta	8	11
Tirana	8	8
Kamza	8	7
Luftëtarit	8	6
Kastrioti	8	4

por në fund nuk ka arritur të dalë i pari. Shpresojmë të jetë ky viti i duhur. **Pikërisht titulli, duket si një mullë e ndaluar për Partizanin.** Detyra jonë është që t'ia bëjmë hyzmetin deri në fund. Me Zotin përpara do t'ia dalim. E kemi vetë fatin tonë në dorë. Jemi një grup djemsh që kemi krijuar një frymë të mirë ekipi, kemi një trajner që na qëndron afër dhe na udhëheq. Kemi drejtuesit që plotësojnë çdo nevojë tonën si dhe kemi tifozët që askush në Shqipëri nuk i ka. Duket se jemi të kompletuar për t'ia dalë mbanë. Megjithatë është ende herët për të dhënë përcaktime. **Meqë përmendët trajnerin. Si është marrëdhënia tuaj me Skënder Gegën?** Si dhe e të gjithë çunave të tjerë. Trajneri nuk bën diferencime mes nesh. Na respekton duke na dhënë secilit atë që meritojmë në bazë të impenjit që japim në stërvitje. Ai ka një filozofi krejt tjetër: është njëkohësisht shok dhe autoritar. Nëse ne deri më tani

jemi në krye, padiskutim që merita më e madhe shkon për trajnerin tonë. **Asani, Mala dhe Bardhi... treshja e tmerrshme e Partizanit!** Asani, Mala dhe Bardhi janë vetëm tre lojtarë që pa pjesën tjetër të ekipit nuk do të kishin kuptim. Të treve na pëlgen të sulmojmë e të shënojmë, por sakrifikojmë si gjithë skuadra në presing dhe në mbrojtje. Në ndjekim udhëtimit e trajnerit dhe kemi një ekip që na e bën punën më të lehtë. Pa ata ne nuk do të ishim këta që jemi sot. **Duket si modesti...** Jo, aspak. Është realiteti. Te Partizani nuk ka gjenralë. Jemi të gjithë ushtarë që duam të gëzojmë tifozët tanë me fitore në lojë dhe pse jo me titullin kampion. **Nuk është sekret. Performanca jote ka rënë në sy përtej kufijve dhe fliet për oferta konkrete që në janar. Ka diçka të vërtetë në këtë histori?** Ikam dëgjuar dhe unë, por sinqerisht nuk më interesojnë aspak zërat e merkatos. Kup-tohet që dëshira e çdo lojtari është ta provojë veten në liga gjithnjë e më të forta, por kjo dëshirë për mua mbetet për të ardhmen. Tani nuk më intereson asgjë tjetër veç Partizanit, tifozëve dhe titullit kampion! **Është java e tetë dhe rivaliteti tuaj më të afërt mbeten Skënderbeu dhe Laçi.** Jo vetëm ata, por edhe Kukësi e Flamurtari kanë ekupe të mira që duhen respektuar. Gjithsesi për ne rivali kryesor është vetja jonë, euforia. Sig e thashë duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë. Ne nuk kemi bërë ende asgjë. **Aktualisht jeni golashënuesi më i mirë i Partizanit. Sa gola mendoni se mund të shënoni në këtë sezon?** Golat më japin kënaqi shumë të madhe, por të njëjtin kënaqësi kam edhe ku asistoj për shokët e ekipit. Te Partizani shënojmë të gjithë dhe kjo na bën vërtet një skuadër të befafshme. Gjithsesi më shumë se golat e mi, më kënaqin tre pikët e skuadrës.

## Fair-Play financiar godet sërish UEFA përjashton Rubin Kazanin nga Europa

Fair Play Financiar" është kthyer në një problem serioz në lidhjen mes klubeve dhe UEFA-s duke qenë se shpesh herë thyhen rregullat e vendosura nga këta të fundit. Transferimet me kosto më të lartë shpenzimi, në krahasim me fitimin kanë bërë që shumë klube të provojnë dënimet e UEFA-s. Kështu, Rubin Kazani është ekipi i radhës që ka rënë pre e dënimit nga UEFA dhe pikërisht "FFP" është arsyeja e dënimit. Në vitin 2014, UEFA dhe klubi rus kanë rënë dakord për një marrëveshje me disa pika, por rusët nuk i kanë zbatuar dhe në kushte të tilla, janë përjashtuar për një vit nga kompeticionet europiane.




Dënimi është i vlefshëm për sezonin pasardhës duke qenë se këtë sezon, Rubin Kazani nuk merr pjesë pasi u rendit në vendin e 10. Si për ironi të fatit, Rubin Ka-


zani ka marrë pjesë për herë të fundit në Europa League para dy sezoneve, duke përfituar nga dënimi i Dinamos së Moskës, pikërisht për të njëjtin arsye.

## Ish-mbrojtësi i Interit Bergomi këshillon Spaletin: Ndal Suson në derbi

Ish-mbrojtësi legjendar i Interit, Bepe Bergomi këmbëngul se mënyra për të fituar derbin, është të neutralizohet Suso. Dy gigantët italianë përplasen të dielën në mbremje në "San Siro" dhe vetëm Paolo Maldini dhe Javier Zanetti kanë luajtur më shumë se 'Zio' Bergomi një derbi. "Dy lojtarët që unë mendoj se mund të vendosin derbin janë Lautaro Martinez dhe Patrik Kutrone, pasi ata mund të vijnë nga stoli dhe të shënojnë.", tha Bergomi për "Sky Sport". "Mënyra për të ndaluar Milanin është duke neutralizuar Suson. Higuain hyn në çdo top të lirshëm dhe ka një goditje të mirë nga distanca, por mendoj se Skriniar mund ta ndalë. Suson... është një mision thuajse i pamundur", - tha Bergomi.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Lindi Isakun.
- Në krye të bashkisë.
- Në djep kur nuk... je.
- Nota e diapazonit.
- Emri i parë i Erasmit të Rotterdamit.
- Mbyllin akte.
- Filozofi i famshëm me historine e gomarit.
- Diku në qendër.
- Rrallë është përgjyemë.
- Bëri edhe Madame Butterfly.
- Norman, psikopati te Psycho.
- Të parat në sjellje.
- Vret me një re.
- Gjarpri që u vra nga Apolloni.
- Lindi Perseun.
- Besniku mesfushor
- Ai i vajtitim është në Jerusalem.
- Carol, aktore.
- Në krye të subjekteve.

- Rrëmbu Helenën.
- Fundi i një samurai.
- Ishin hipokritë për Krishtin.
- Ngrin... nga frika.
- Përdorej kundër malaries.
- Perëndia që u zu në gjumë nga Mene-lau dhe Aristeu.
- Tund në ekstreme.
- Piaf e Milord.
- Në hyrje të sallës.
- VERTIKAL
- Ishte sundimtari i provincave perseisha.
- Inicialet e Duvall
- Qytei i njembinjëdritarve.
- Ishin armiqtëe babilonasve.
- Shkroi Jacuqes le fataliste
- Është edhe tendencë.
- Joan i interpretuar nga Celentano.
- Jetojnë në vetmi.
- U soll në Europë në Jean Nicot.
- Ai i Aida-s është Radames.

- Një ishte edhe Decebali.
- Inicialet e Rohmer regjisor.
- Titulli i Bruce Springsteen.
- Hidhet një me... kërcim.
- U shkrua nga Camus.
- Fillojnë takimin.
- Fillojnë natën.
- Pierce teniste.
- Grisur pa gur.
- Fillojnë panikun.
- Shijuar pa shuar.
- Fleming, që krijoi James Bond.
- Kështu merr ai që... mbaron.
- Mbajtësja e topit në golf.
- Ekstreme për gotik.
- Carson i fumnetti-t.
- Një padi kur s'është ai.
- Bëhen arianë me një anë.
- Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
- Bëhet nuse me ne.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Emri i Monet.
- Një top në rrjetë.
- Carl Edward, që shkroi Contact.
- Qe bukuoshi që u hidhte ferë përëndive.
- Qe era hyjnore e japonezëve.
- Një pjesë e lartësive.
- Muzikanti që... nuk përsëriste.
- Lumë në Rusi.
- Është i lartë ai i kampionit.
- Kalifi që themeloi Kairon.
- Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
- Janë në guvë.
- Iloni portier.
- Markë makine.
- Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
- Inicialet e Mann.
- Një parabolë e tenistit.
- Fillojne tatepjeten.

**VERTIKAL**


- Inicialet e Santana-s, kitarist.
- Nota e diapazonit.
- Është frika nga shehet e hapura.
- Diftong në duar.
- Duhan në ekstreme.
- Qe libri erotik i Mallanaga Yatsuyana-s.
- Lauda ish-pilot i Formula 1.
- Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
- Një poemë.
- Fund tuneli.
- Një elegant si Aramis.
- Qe kryeqyteti i Asirisë.
- Qe toreador i famshëm.
- Urdhëroi sakrificimin e Ifigjienas.
- Është pushteti i... bashkisë.
- Qe lumi i Karontit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishte gjuha e Jezu Krishtit.
- U shndërrua në dre nga Afërdita.
- Rex i Nero Wolfe.
- Nino, kompozitor i njohur.
- Një... story e John Le Carré.
- Shkroi Tregime të sjhtëzakonshme.
- Kufizojnë një sektor.
- Inicialet e Einstein.
- Inicialet e Matthieu, këngëtare.
- Kufizojnë sportet.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQIVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

A F M P K A G I M  
T I K M O D E L E T R I  
K A P I T E N E T R I Z  
P I R A T E R I A S O  
P A R A K A L I M E T R I  
E R C G E R O R A R I  
N O I R E T P E L L E A  
M T N M A L O R E I A  
L E E D S A R A G O N A  
N E E S O N O R S E A T  
G U T T U S O E D I T I  
E D L T E C M A F I A  
C K O P E R R D E R R  
O H A R A D I A M A N T I  
E P E R D I T S H M E I  
S T A D I U M E T I R A N  
D I N A S T E R I L R A  
M E N N I S S A N  
N O T A S U E L E N A  
O R T R I M A B O N E  
V E S I M O T E N D  
K A A M E N E T R E N E  
K A R A K T E R E T T R

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

	8	6	7	9				
		9	4	1	5			
						2		
6						8	7	
	7						1	
5		9		1	2			
8								7
						1	4	
		2	8			9	3	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	9	8	1	2	4	6	3	5
5	6	1	3	7	9	4	8	2
2	3	4	5	6	8	7	9	1
8	5	7	6	1	3	9	2	4
3	2	6	9	4	7	1	5	8
4	1	9	2	8	5	3	6	7
6	8	2	7	9	1	5	4	3
1	4	5	8	3	6	2	7	9
9	7	3	4	5	2	8	1	6

*Argëtim filozofik*

- Tri raste kanë tri virtyte shumë të pëlqyeshme: të ndihmohesh nevojtarët kur janë në gjendje të vështirë, të thuash të vërtetën edhe në zemërim, të falësh kur je i zoti të ndëshkosh ose të hakmerresh.
- Për ndryshimin e një gjëje askush nuk është më i aftë se koha.
- Ti japësh pozitë dhe të nderosh një njeri pa merita është si të hedhësh në ndyrësira një qese me inxhi (margaritarë).



**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	K	A	12	F	3	E	2	1	6	3	10	2	
1	9	1	8				11	1	12		2	3	7
3	2	2			13	3	11	1	2	4	2	4	
3	2		13	3	7	3	2	4	5	3			
15		5	9	8	4	2	3	2	3	2			
9		3	5	4	11	3	2		2		12		
7	4	5		10	3	2	2	2	1	11	1		
4		9		15	16				17	2	4	6	
5	1		17	20	4	10	15				17	6	
3	9			11	1	2	3	10	2	1	2		
10	1			19	3			18	7	1	2		
1	19	8	4				11	4	7	1	2	4	

P U S I K U P T O P  
U R A R O A S L I  
S I P E L E R I N A T  
H P A N O R A M A T  
T R I P A N O Z O M A  
E P A T A T I N A T  
T E S A I T T O D  
I A R P R A N I M E  
R I C H T E R S I L  
S T I L E T E U K E  
R U Z A T R E  
R I C H A R D T A

*Thënie të mençura*

- Po të bjerë në det një pikë ujë, nuk thahet.
- Sikundër që elefantin e vrasin për dhëmbët e tij të çmueshëm, disa guaska deti i guajnë për margaritarët që kanë brenda e që bilbilin e robërojnë për zërin e tij të bukur, kështu edhe njeriun — të shumtën e herës — e rrezikon vlera e tij e lartë.
- Mos lu mbështet të nesërmes, nuk mund të dish se çdo të lindë nata.
- Pa atashim s'mund të ketë as opinion publik, as forcë.
- Liria s'mund të shkojë përpara pa pasur udhëheqëse arsyen dhe pa qenë e shoqëruar nga vetitë e mira.

